

# ROMACTED

*Promovimi i qeverisjes së  
mirë dhe fuqizimit Rom  
në nivelin vendor*

## BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM PËR PAKICAT ROME DHE EGJIPTIANE NË NIVEL VENDOR NË SHQIPËRI

Udhëzues për Bashkitë



Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës



# ROMACTED

*Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor*

**Buxhetimi i Përgjigjshëm për Pakicat Rome dhe Egjiptiane në Nivel Vendor në Shqipëri**

*Udhëzues për Bashkitë*

## **Programi ROMACTED**

Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor

**Program i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës**

### **Redaktor:**

Orsiola Kurti

Oficere e Projektit ROMACTED për Shqipërinë

### **Ekspertë:**

Raimonda Duka

Rezart Xhelo

Tiranë, 2020



Ky dokument u prodhua me ndihmën  
financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit  
të Evropës.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim  
nuk mund të merren në asnjë mënyrë si  
përfaqësim i opinionit zyrtar të Bashkimit  
Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Publikuar në kuadër të projektit “ROMACTED:  
Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit  
Rom në nivelin vendor”.

Të gjithë të interesuarit në riprodhimin  
ose përkthimin e një pjese ose të të gjithë  
dokumentit lejohen me aprovimin paraprak të  
Programit ROMACTED (romacted@coe.int).

Faqja e parë: Gent Grafik sh.p.k.

Publikuar prej Programit ROMACTED

Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë

Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës

Kati i tretë, Tiranë, Shqipëri

[www.coe-romacted.org](http://www.coe-romacted.org)

[www.coe.al](http://www.coe.al)

[www.ec.europa.eu](http://www.ec.europa.eu)

© Programi ROMACTED, Dhjetor 2020



## Tabela e përmbajtjes

Përhëndetje .....	9
Hyrje .....	11
Struktura e udhëzuesit .....	13
I. Buxhetimi i përgjigjshëm për pakicat rome dhe egjiptiane .....	14
I.1 Pse një udhëzues? .....	14
I.2 Objektivat e udhëzuesit .....	15
I.3 Metodologjia .....	16
II. Angazhimet ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore .....	17
II.1 Kuadri ligjor .....	17
II.2 Strategjitë dhe planet kombëtare .....	19
II.3 Strategjitë dhe planet vendore për integrimin e romëve dhe egjiptianëve 21	
III. Përse duhen përfshirë nevojat e pakicave rome dhe egjiptiane në buxhet? .....	23
III.1 Hendeku midis politikave dhe buxhetit për nevojat e pakicave .....	23
III.2 Integrimi i perspektivës rome dhe egjiptiane në buxhet si faktor për fuqizimin e pakicave .....	24
III.3 Përfitimet nga zbatimi i buxhetimit të përgjigjshëm për pakicat rome dhe egjiptiane .....	24
III.4 Rritja e llogaridhënies dhe transparencës në hartimin e buxhetit .....	26
III.5 Praktikat e mira për përfshirjen e romëve në vendet e BE-së .....	26
IV. Hapat për integrimin e nevojave/prioriteteve të pakicave rome dhe egjiptiane në buxhetin vendor .....	29
IV.1 Hartimi i buxhetit të përgjigjshëm vendor për perspektivën e pakicave .....	29
IV.2 Kategorizimi i programeve buxhetore sipas perspektivës së pakicave .....	34
IV.3 Përcaktimi i produkteve, rezultateve, treguesve dhe shpenzimeve me perspektivën rome dhe egjiptiane .....	43



IV.4 Garantimi i përfshirjes së nevojave të pakicave rome dhe egjiptiane në buxhet .....	50
IV.5 Hartimi i deklaratës për buxhetimin e përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët .....	52
IV.6 Monitorimi i politikave dhe buxhetimit të përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët .....	56
Aneks 1: Konventat, ligjet dhe aktet nënligjore .....	63
Instrumentet në kuadrin e OKB-së .....	63
Instrumentet në kuadrin e Këshillit të Evropës .....	64
Standardet e Bashkimit Evropian .....	64
Kuadri Ligjor Shqiptar .....	64
Referencat .....	65

### Tabelat

Table 1: Lidhja e programeve buxhetore me përfshirjen e pakicave rome dhe egjiptiane .....	37
Table 2: Plani i Bashkisë Korçë 2019-2022.....	44
Table 3: Shembuj nga programet buxhetore .....	47
Table 4: Deklarata për buxhetin e përgjigjshëm rom dhe egjiptian .....	54
Table 5: Raportimi i shpenzimeve për masat për pakicat rome dhe egjiptiane në buxhetin e 2019 .....	57
Table 6: Shpenzimet faktike për pakicat rome dhe egjiptiane sipas programeve buxhetore.....	58
Table 7: Nivelet e ndryshme të monitorimit .....	61



## Shkurtime

AB	Arsim Bazë
AK	Aftësi e kufizuar
BE	Bashkimi Evropian
BP	Buxhet i përgjigjshëm
EMP	Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
KB	Këshilli Bashkiak
KE	Këshilli i Evropës
MB	Ministria e Brendshme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NE	Ndihmë ekonomike
NJVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
RCC	Regional Cooperation Council









**Jutta Gützkow**

Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë

## Përshëndetje

Shqipëria, si vend anëtar i Këshillit të Evropës prej vitit 1995, është angazhuar kundrejt parimeve dhe detyrimeve nën Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Kartën Sociale Evropiane si edhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore.

Mbështetja dhe bashkëpunimi ynë me autoritetet vendore në Shqipëri ngrihet mbi një partneritet të gjatë për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut në praktikë, me fokus mbi mosdiskriminimin, respektimin e dallimeve dhe diversitetit dhe pjesëmarrjen efektive të romëve si anëtarë të barabartë në shoqërinë shqiptare. ROMACTED, programi i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës mbi promovimin e qeverisjes së mirë dhe fuqizimit rom në nivelin vendor, ka kontribuar gjatë tre viteve të shkuara në ndërtimin e gatishmërisë politike dhe angazhimit të qëndrueshëm në nivel politikash të autoriteteve vendore, për të nxitur qeverisjen demokratike vendore dhe përfshirjen e romëve në nivel komunitar.

Udhëzuesi mbi “Buxhetimin e Përgjigjshëm Rom dhe Egjiptian në Nivelin Vendor” përbën një përshtatje në kontekstin vendor shqiptar të Udhëzuesit të Përgjigjshëm Rom zhvilluar prej Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal/Ekipi i Integritimit Rom drejtuar qeverive në nivelin qendror në Ballkanin Perëndimor. Kjo përshtatje u zhvillua nën Programin ROMACTED në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Financave



Vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Udhëzuesi përcakton një kornizë të përgjithshme se si buxheti i përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët mund të përdoret gjatë gjithë ciklit të buxhetit për të ndihmuar njësitë bazë të qeverisjes vendore dhe aktorët e shoqërisë civile rome për të promovuar mundësi të barabarta në nivelin vendor.

Ky udhëzues u brendësua nën Udhëzimin zyrtar Nr. 10 datë 28/02/2020 mbi “Përgatitjen e Buxhetit Afat-Mesëm 2021-2023 për njësitë e vetëqeverisjes vendore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Programi ROMACTED mbështeti ciklin e planifikimit buxhetor përgjatë 2020 për të siguruar planifikim afatmesëm të përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët. Gjithashtu, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore u bashkuan përpjekjet për masa të ngritjes së kapaciteteve.

Jam e bindur që ky libërth do të gjejë zbatim efektiv prej vendimmarrësve në nivelet qendrore dhe vendore, si edhe prej përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe me më tepër rëndësi prej pakicave rome dhe egjiptiane gjatë proceseve vendimmarrëse dhe përgatitjes së buxheteve vendore në Shqipëri.



## Hyrje

Udhëzuesi paraqet buxhetimin e përgjigjshëm dhe si mund të zbatohet praktikisht në nivel vendor. Ai është hartuar për të nxitur zbatimin e efektshëm dhe të synuar të buxhetit të përgjigjshëm për pakicat rome dhe egjiptiane. Udhëzuesi është hartuar gjithashtu për të mbështetur njësitë e vetëqeverisjes vendore<sup>1</sup> (NVJQV-të) për të siguruar transparencën e përdorimit të buxhetit ndaj grupeve të interesit. Udhëzuesi i referohet ekskluzivisht shpenzimeve buxhetore. Fokusi është në fondet buxhetore, që kanë në dispozicion NVJQV-të<sup>2</sup> (të ardhurat e veta, fondet e transferuara nga buxheti i shtetit, si dhe burime të tjera të parashikuara me ligj).

NVJQV-të ndikojnë në përmbushjen e detyrimeve për të drejtat e pakicave kombëtare<sup>3</sup>, pasi në këtë nivel ofrohen shërbime dhe përdoren burime në përmbushjen e të drejtave të tyre në fusha të ndryshme<sup>4</sup>. Nismat për buxhetimin e përgjigjshëm, që përfshijnë NVJQV-të dhe aktorë të tjerë, si OSHC-të, kërkuesit ose grupet me bazë komunitare, janë më efektive dhe të qëndrueshme.

Aktorët kryesorë vendorë janë Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak, drejtuesit e departamenteve/drejtorive të ndryshme, nëpunësit vendorë, organizatat e shoqërisë civile vendore, aktivistët romë dhe egjiptianë, pakicat rome dhe egjiptiane, etj.

- **Kryetari i Bashkisë** është i rëndësishëm për të dëshmuar vullnetin politik për zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm dhe për të dhënë udhëzime politike për procesin e buxhetimit.
- **Drejtuesit e departamenteve/drejtorive** të ndryshme dhe ekspertiza e tyre teknike për planifikimin strategjik, buxhetimin, politikat sektoriale dhe ato që synojnë pakicat rome dhe egjiptiane kanë një rol të rëndësishëm në kryerjen e analizës së buxhetit të përgjigjshëm, duke mundësuar që perspektiva e integritit të romëve dhe egjiptianëve të përfshihet në proceset e planifikimit dhe buxhetimit.
- **Nëpunësit vendorë** orientohen se si të zbatojnë një proces buxhetimi, që konsiston në një bashkësi mjetesh për ta bërë atë një instrument real për të adresuar nevojat e pakicave rome dhe egjiptiane. Ata gjithashtu bëhen më të përgjigjshëm dhe më të besuar në planifikimin e fondeve publike, në përputhje me nevojat dhe pritjet që kanë pakicat rome dhe egjiptiane.

1 Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore

2 Ligji Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"

3 Ligji Nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH", neni 8

4 Ligj Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 3



- **Këshilli Bashkiak dhe Komisionet e tij** kanë një rol madh në ngritjen e çështjeve të integritimit të pakicave rome dhe egjiptiane gjatë diskutimeve mbi buxhetin dhe mundësisht të nxisin ndryshime në shpërndarjet e fondeve të akorduara në buxhet.
- **Përfaqësuesit e zgjedhur të pakicave, aktivistët romë dhe egjiptianë dhe OJF-të** përmes këtij udhëzuesi mësojnë si të bashkëveprojnë me qeverisjen vendore në të gjitha fazat e ciklit të buxhetit për të sjellë zërin e pakicave rome dhe egjiptiane në procesin e buxhetimit. Megjithatë duhet nënvizuar që aktorët e shoqërisë civile dhe Këshilli Bashkiak kanë role të ndryshme, për të propozuar instrumenta në zbatim të politikave dhe ndryshimeve konkrete, për të krijuar mekanizma për monitorimin e buxhetit ose për të rritur ndjeshmërinë për rëndësinë e planifikimit dhe buxhetimit për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane.
- **Pakicat rome dhe egjiptiane** përfitojnë nga zbatimi i këtij udhëzuesi. Ato do të sqarohen rreth përmbajtjes së buxhetit, mundësive dhe kufizimeve dhe do të përfshihen gjithnjë e më tepër në vendimmarrjen për shpërndarjen e fondeve publike. Përdorimi i udhëzuesit i rekomandohet të gjithë aktorëve të sipërpërmendur, por në mënyrë të veçantë anëtarëve të Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe anëtarëve të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve në bashki. Ai ka për qëllim të sigurojë mbështetje praktike në procesin e fillimit dhe zbatimit të punës për buxhetin e përgjigjshëm në bashkinë e tyre.

Të zgjedhurit vendorë, nëpunësit e administratës vendore dhe grupet e interesit do të gjejnë në këtë udhëzues hapa praktike se si mund të realizojnë buxhetimin e përgjigjshëm në njësitë e tyre. Udhëzuesi i ndihmon ata të kuptojnë se si mund të përshtasin përparësitë e tyre dhe të shpërndajnë burimet për të përmbushur angazhimet dhe për të arritur fuqizimin dhe integrimin e pakicave rome dhe egjiptane. Propozimet, sugjerimet, çështjet e ngritura nga pakicat do të përmirësonin procesin e planifikimit të shpenzimeve mbështetur në nevoja. Udhëzuesi ka gjithashtu si qëllim që të jetë një material plotësues për ngritjen e kapaciteteve për nëpunësit vendorë.

Udhëzuesi është hartuar në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “ROMACTED: Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivel vendor”. Kjo nismë vijon krahas mbështetjes kundrejt institucioneve qendrore dhe autoriteteve vendore për të zbatuar procesin e buxhetimit të përgjigjshëm për pakicat rome dhe egjiptiane në nivel vendor.



## Struktura e udhëzuesit

Udhëzuesi është strukturuar si më poshtë:

### Pjesa I

Nevojat e një udhëzuesi për buxhetimin e përgjigjshëm për pakicat rome dhe egjiptiane, objektivat e hartimit të këtij udhëzuesi dhe metodologjia e përdorur për hartimin e tij.

### Pjesa II

Përmbledhje e kuadrit ligjor, strategjive dhe planeve kombëtare dhe vendore, që parashikojnë masa për fuqizimin e pakicave rome dhe egjiptiane.


### Pjesa III

Hendeku midis politikave dhe burimeve financiare për të adresuar fuqizimin e romëve dhe egjiptianëve, si mund të integrohet perspektiva e këtyre pakicave në buxhetet vendore, çfarë përfitimesh mund të sjellë zbatimi i buxhetimit të përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët dhe proceset që mund të rrisin përgjegjshmërinë në hartimin e buxhetit.

### Pjesa IV

Hapat që mund të ndiqen për integrimin e nevojave të këtyre pakicave në buxhetin e bashkive.





## I. Buxhetimi i përgjigjshëm për pakicat rome dhe egjiptiane

### I.1 Pse një udhëzues?

Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në 2015 ka vënë në dukje që:

- Romët dhe Egjiptianët përballen me kufizime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në aksesin e shërbimeve publike.
- Niveli i varfërisë në radhët e pakicës rome është dy herë më i lartë se në pjesën tjetër të popullatës, ndërsa niveli i papunësisë është tre herë më i lartë se mesatarja.
- Tridhjetë e nëntë për qind e banesave të romëve dhe 21 për qind e atyre ku banojnë egjiptianët nuk furnizohen me ujë të pijshëm.
- Romët kanë mesatarisht një moshë vdekjeje të paktën dhjetë vjet më të re sesa popullsia tjetër jo-rome dhe kanë shkallë më të lartë të vdekshmërisë foshnjore.
- Romët dhe egjiptianët përfundojnë mesatarisht 5-6 vjet arsim, krahasuar me mesataren kombëtare që është 10 vjet.<sup>5</sup>

Buxheti i përgjigjshëm është një mekanizëm i rëndësishëm për të siguruar përputhshmëri më të madhe midis qëllimeve ekonomike dhe angazhimeve sociale. Buxhetimi i përgjigjshëm rom dhe egjiptian është një qasje, që synon të harmonizojë politikat për fuqizimin dhe integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane me burimet financiare të nevojshme për zbatimin e tyre. Argumenti më i përdorur për ndërmarrjen e nismave për buxhetimin e përgjigjshëm është se ai çon në një përdorim më të efektshëm të burimeve.

Buxhetimi i përgjigjshëm për pakicat rome dhe egjiptiane është një qasje e re. Realizimi i këtij procesi është përkufizuar si më poshtë në udhëzimet e përgatitura prej Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC): “Buxhetimi i përgjigjshëm rom siguron

5 PKV për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, fq. 6, 2015



një analizë të buxhetit nga perspektiva e integritimit rom dhe paraqet përfshirjen e perspektivës të barazisë romë në të gjitha politikat, në të gjitha nivelet dhe të gjitha fazat brenda procesit të buxhetimit<sup>6</sup>.

Buxhetimi i përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët është një instrument, që ndihmon NJVQV-të për të planifikuar, programuar dhe buxhetuar programe dhe/ose projekte, që kontribuojnë për të fuqizuar dhe integruar pakicat romë dhe egjiptiane në nivel vendor. Buxhetimi i përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët nuk ka të bëjë me krijimin e një buxheti të veçantë për këto pakica, përkundrazi, bëhet fjalë për një politikë buxhetore të barabartë, por që mban në konsideratë nevojat e tyre. Ky tipar kërkon që buxhetimi i përgjigjshëm të zbatohet në të gjitha fazat e ciklit të buxhetit.

Buxhetimi i përgjigjshëm mund të përmirësojë gjithashtu efektivitetin, efçencën, përgjegjshmërinë dhe transparencën e buxheteve të NJVQV-ve. Përmes këtij procesi mund të vihen në dukje përparësitë buxhetore dhe mospërputhjet midis asaj që një bashki thotë se po bën dhe ndikimit aktual të politikave që zbaton.

Zbatimi i buxhetimit të përgjigjshëm për pakicat do të thotë që shpërndarja e fondeve për integrimin e romëve dhe egjiptianëve të bëhet përmes programeve buxhetore ekzistuese mbështetur në politikat vendore dhe ato kombëtare. Në rastet kur evidentohen kushte të veçanta ose hendeqe të rëndësishme mund të vihet në dispozicion buxhet specifik për zbatimin e projekteve të veçanta.

Ky udhëzues ka për qëllim të mbështesë zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët duke ilustruar hapat e mundshëm, si dhe duke ofruar shpjegime për vlerësimin e ndikimit të buxhetit në fuqizimin e këtyre pakicave. Udhëzuesi mbi buxhetin e përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët është hartuar për të qenë një kornizë e përgjithshme referimi për njësitë e vetëqeverisjes vendore, që mund të lehtësojë zhvillimin e praktikave të mira për menaxhimin e financave publike duke mundësuar që buxhetet vendore të adresojnë praktikisht prioritetet dhe angazhimet e tyre për fuqizimin e pakicave romë dhe egjiptiane.

## 1.2 Objektivat e udhëzuesit

Qëllimi kryesor i këtij udhëzuesi është përcaktimi i një kornize të përgjithshme se si buxhetimi i përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët mund të përdoret gjatë gjithë ciklit të buxhetit për të ndihmuar njësitë e vetëqeverisjes vendore të promovojnë barazinë e mundësive mbështetur në legjislacionin ekzistues mbi buxhetin dhe financat vendore.

6 Regional Cooperation Council, Roma Integration 2020, *Guideline for Roma Responsive Budgeting*, fq.16



Objektivat specifikkë të këtij udhëzuesi janë:

- Të rekomandojë procedura dhe hapa se si aktorë të ndryshëm kryesorë të mund të mbështesin zhvillimin e buxheteve të përgjigjshme për pakicat romë dhe egjiptiane në nivel vendor.
- Të harmonizojë buxhetin vendor me planin kombëtar të veprimit dhe planet vendore për integrimin e romëve dhe egjiptianëve.
- Të rekomandojë standarde bazë në buxhetimin e përgjigjshëm për këto pakica, që mund të lehtësojnë ngushtimin e hendekut midis angazhimeve kombëtare dhe vendore dhe shpenzimeve publike për uljen e pabarazive.
- Të ilustrojë praktikatat e mira në buxhetimin e përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët, që mund të zbatohen në kushte të ngjashme në njësi të ndryshme vendore.
- Të mundësojë realizimin praktik të fuqizimit në të gjithë sektorët kryesorë (strehim, arsim, punësim dhe shëndetësi) me synim uljen e varfërisë.

### I.3 Metodologjia

Hartimi i udhëzuesit u realizua në konsultim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Puna filloi me hartimin e strukturës së udhëzuesit, që u aprovua prej ekipit zbatues. Më pas u hartua një draft i parë i udhëzuesit, i cili u diskutua në Mbledhjen e Tretë të Grupit Këshillimor të Programit. Gjatë mbledhjes u krijua hapësirë për diskutimin e draftit, shkëmbimin e praktikave të mira dhe sfidave në zbatimin e një buxheti të përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët.


Metodologjia për përgatitjen e këtij udhëzuesi përfshiu gjithashtu elementët e mëposhtëm:

- Një rishikim i literaturës aktuale mbi buxhetimin e përgjigjshëm, në veçanti me fokus në buxhetimin e përgjigjshëm rom<sup>7</sup>.
- Intervista të shkurtra, gjysmë formale, me stafin e drejtorive të buxhetit në NJVQV- të e përfshira në projekt.
- Analiza e praktikave të mira të zbatuara nga NJVQV-të në hartimin e PBA-së 2019-2021.
- Për ta bërë udhëzuesin më gjithëpërfshirës për nevojat dhe interesat e palëve të interesuara dokumenti u nda me përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe bashkitë e përfshira në projekt për të marrë komente, vërejtje dhe sugjerime, të cilat u reflektuan në variantin përfundimtar të udhëzuesit.

7 Ref. RCC Guidelines for Roma Responsive Budgeting, 2018







## II. Angazhimet ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore

Buxhetimi i përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët edhe pse nuk ka referim të drejtpërdrejtë në legjislacionin shqiptar, gjen mbështetje në bazën ligjore ekzistuese dhe në disa dokumente politike. Qëllimi kryesor i këtij kapitulli është të paraqesë në mënyrë të përmbledhur legjislacionin, strategjitë dhe planet kombëtare dhe vendore, që synojnë të sigurojnë fuqizimin dhe integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane, të cilat mund të përdoren si bazë ligjore për buxhetin e përgjigjshëm, si dhe për të nxjerrë argumente mbështetëse shumë të forta për këtë proces.

### II.1 Kuadri ligjor

Të drejtat e njeriut mishërojnë kërkesat minimale për një jetë dinjitoze, e zbatueshme për të gjithë njerëzit kudo. Për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut qeveria shqiptare ka miratuar një numër të konsiderueshëm aktesh ligjore dhe nënligjore, që garantojnë respektimin e këtyre të drejtave. Konventat ndërkombëtare të ratifikuara, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore, përbëjnë bazën për garantimin dhe respektimin e këtyre të drejtave. *(shih për më shumë listën e akteve, aneksin nr.1)*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si vlera, që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik shqiptar. Në nenin 18/1 të Kushtetutës është parashikuar parimi i barazisë në të cilin sanksionohet se “*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit*” dhe në nenin 18/2 parimi i mosdiskriminimit, në përmbajtjen e të cilit sanksionohet se “*Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore*” dhe neni 20/1 “*personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre*”.

Qeveria ka për detyrë të sigurojë që kjo barazi të realizohet në praktikë. Këto dispozita kanë një rëndësi të veçantë pasi sistemi i planifikimit dhe buxhetimit është një nga instrumentet qendrore të administratës publike për të siguruar që



prioritetet dhe politikat të zbatohen mirë dhe të arrihen rezultate. Kështu që, për të siguruar që barazia për pakicat romë dhe egjiptiane ekziston në praktikë, planifikimi i përgjigjshëm dhe buxheti është thelbësor. Në këtë sens, Kushtetuta e RSH ofron një bazë për buxhetin e përgjigjshëm. Një buxhet i hartuar, zbatuar dhe vlerësuar me kujdes është thelbësor për realizimin e të gjitha të drejtave të pakicave romë dhe egjiptiane.

Shqipëria ka ratifikuar disa konventa, të cilat janë instrumenta ligjorisht të detyrueshme në lidhje me të drejtat e njeriut<sup>8</sup>. Kanalizimet e duhura janë të domosdoshme nëse njerëzit duhet të jetojnë në dinjitet dhe të gëzojnë të drejtën e tyre për shëndet, të garantuar sipas nenit 12 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966). Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të përshtatshme të kanalizimeve kërkon investime në infrastrukturë nga NJVQV-të. Një pjesë e madhe e pakicës romë është e vendosur në vendbanime ku mungon infrastruktura e nevojshme<sup>9</sup>.

E drejta për arsim është thelbësore për aftësimin e njerëzve për të realizuar të drejtat e tyre për punë dhe në këtë mënyrë të mbështesin veten dhe familjet e tyre (neni 28 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966) dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (1989), por gjithashtu për të realizuar të drejtën e tyre për akses në informacion dhe për të marrë pjesë në jetën qytetare të vendit. Arsimi kërkon jo vetëm klasa të ndërtuara mirë dhe të pajisura me një numër të mjaftueshëm pajisjesh, por gjithashtu mësues të paguar me pagën e duhur, të aftë dhe të motivuar.<sup>10</sup>

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”<sup>11</sup> ndalon diskriminimin në bazë të përkatësisë racore ose etnike në fushën e punësimit, arsimit, aksesit dhe furnizimit me mallra dhe shërbimeve, që janë në dispozicion të publikut, duke përfshirë strehimin, mbrojtjen sociale, përfshirë sigurimin social dhe kujdesin shëndetësor, avantazhet sociale, etj. Qëllimi i ligjit është të sigurojë të drejtën e çdo personi për, “barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike<sup>12</sup>. Fushat kryesore në të cilat sigurohet kjo mbrojtje ligjore përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi në punësim si dhe gjatë periudhës së ushtrimit të marrëdhënieve të punës, në fushën e arsimit si dhe në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Buxheti vendor është dokumenti më i rëndësishëm i NJVQV-ve për të realizuar në praktikë disa nga këto të drejta.

8 Shih Aneks 1

9 OSFA, Dekada e romëve dhe situata e romëve në Shqipëri 2012

10 Realizing Human Rights through Government Budgets, UN Human Rights Office dhe International Budget Partnership, New York dhe Geneva, 2017, fq.12

11 Ligji është në përputhje të plotë me Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e barazisë dhe konkretisht është përfuar plotësisht me: Direktivën 2000/43/KE për Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”

12 Ligji nr 10221, datë 04.02.2019 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 2



Që prej tetorit të 2017, romët dhe egjiptianët janë njohuri si dy prej pakicave kombëtare në Shqipëri<sup>13</sup>. Ligji Nr. 96/2017 "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë", në nenin 8, pika 2.a nënvizon që "Institucionet publike, qendrore dhe **vendore**, miratojnë dhe zbatojnë masat e nevojshme: a) për të garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës". Efektet e këtij ligji për buxhetin e NJVQV-ve janë: shpërndarja e fondeve dhe realizimi i shpenzimeve për ato masa/projekte që janë të përshtatshme për të realizuar një të drejtë specifike (për shembull, për të siguruar strehim, për të rritur aksesin në arsimin parashkollor, për të siguruar furnizimin me ujë të pijshëm, për të ruajtur traditën dhe kulturën e tyre, etj.

E drejta e fëmijëve të pakicave për të përdorur gjuhën e tyre me anëtarët e tjerë të komunitetit dhe zhvilluar kulturën e tyre garantohet nga neni 33 i ligjit "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<sup>14</sup>. Ushtrimi i kësaj të drejte për pakicat rome dhe egjiptiane kërkon financimin e projekteve, që ruajnë trashëgiminë kulturore të këtyre pakicave, financimin e "Qendrave komunitare", që mbështesin shërbime të ndryshme për këto komunitete, zbatimi i përjashtimit nga të gjitha detyrimet financiare për të rritur frekuentimin e institucioneve të arsimit parashkollor me kohë të plotë për fëmijët nga familjet rome dhe egjiptiane me të ardhura të ulëta mujore.

## II.2 Strategjitë dhe planet kombëtare

Qeveria shqiptare ka hartuar dhe miratuar politika të përgjithshme, sektoriale dhe politika specifike për romët dhe egjiptianët. Disa nga dokumentet strategjike që synojnë këto pakica janë:

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020** përfaqëson dokumentin themelor strategjik, që kombinon agjendën e integritit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit. Në fushën e të drejtave të njeriut synohet "një shoqëri që respekton dhe mbron të drejtat e njeriut, garanton parimin e barazisë dhe promovon shanse dhe mundësi të barabarta si një mjet efikas për një demokraci të konsoliduar dhe shtet ligjor"<sup>15</sup>.

**Strategjia e Mbrojtjes Sociale (2019-2022)** synon reduktimin e varfërisë (sidomos varfërinë ekstreme) duke garantuar një jetesë dinjitoze për familjet/individin dhe duke nxitur zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të tyre nëpërmjet adresimit të

13 Ligji Nr. 96/2017 "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë" miratuar më datë 13.10.2017 dhe ka hyrë në fuqi në nëntor 2017

14 Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"

15 SKZHI 2015-2020, fq.



nevojave në kontekstin e rehabilitimit dhe të shërbimeve shoqërore. Ajo synon gjithashtu që t'i sigurojë çdo qytetari shqiptar pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, **etnisë**, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbimeve publike cilësore. Strategjia ka përcaktuar qëllime, objektiva dhe masa në tri fusha kryesore: zhvillimi i ndihmës ekonomike, zhvillimi i aftësisë së kufizuar dhe zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor, të cilat synojnë *zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë, përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara dhe sigurimin e një qasjeje të barabartë në një sistem funksional dhe të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror*.<sup>16</sup>

### **Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (2016-2020)**

synon rritjen e aksesit në shërbimet publike nëpërmjet heqjes së vazhdueshme të pengesave për romët dhe egjiptianët. Për arritjen e synimit janë përcaktuar objektivat specifike si: lehtësimi i mundësive për shfrytëzimin e barabartë të regjistrimit civil dhe drejtësisë; aksesit dhe përfshirjes së plotë në arsimin cilësor; krijimit të mundësive të barabarta për punësimin formal; garantimit të një kujdesi mjekësor të aksesueshëm, të përbalueshëm dhe të barabartë; përmirësimit të kushteve të strehimit dhe rritjes së aksesit në programet sociale.<sup>17</sup> Plani, përmban objektiva specifike dhe masa konkrete, në gjashtë fusha prioritare: regjistrimi civil, arsimi dhe dialogu ndërkulturor, punësimi dhe zhvillimi i aftësive, kujdesi shëndetësor, strehimi dhe integrimi urban, si dhe mbrojtja sociale, që synojnë të përmirësojnë jetesën e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri.

Integrimi evropian nuk përfaqëson vetëm një mundësi për vendin, por edhe një sfidë për sa i përket realizimit të reformave strukturore, që janë në proces dhe që do të nevojiten për aderimin dhe kalimin në një ekonomi tregu bashkëkohore si dhe ndërtimin e një shteti ligjor shtet anëtar i Bashkimit Evropian. **Udhërrëfyesi** për 5 prioritetet e rekomanduara nga BE kërkon *"Marrjen e masave efektive për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë politikën për romët dhe anti-diskriminimin, si dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë"*.<sup>18</sup> Udhërrëfyesi dhe rekomandimet e seminarit të dialogut publik Shqipëri-BE (2018-2020) orientojnë marrjen e masave specifike për romët dhe egjiptianët në fushën e arsimit, kujdesit shëndetësor, tregut të punës dhe formimit profesional, strehimit, mbrojtjes sociale, etj.<sup>19</sup>

<sup>16</sup> Strategjia e mbrojtjes sociale 2019-2022

<sup>17</sup> Fletore zyrtare nr. 241/2015, fq. 16411-16412 (Plani kombëtar i veprimit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, 2016-2020)

<sup>18</sup> Prioriteti 5

<sup>19</sup> Udhërrëfyesi për 5 prioritetet, BE strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore, 2013-2015, fq. 19



Ndërkohë që **strategjitë sektoriale**<sup>20</sup> janë fokusuar kryesisht në ofrimin e programeve të specializuara, që lehtësojnë aksesin në tregun e punës dhe rrisin mundësitë e punësimit; ofrimin e mundësive për ndjekjen e arsimit të detyrueshëm dhe të mesëm për personat, që kanë kaluar moshën e arsimit të detyrueshëm dhe që nuk e kanë përfunduar atë; shtrirja e shërbimeve psikologjike, veçanërisht në shkollat ku ka fëmijë romë dhe egjiptianë dhe nxënës, që rrezikojnë të braktisin shkollën; lehtësimi i aksesit të grupeve në nevojë në shërbimet shëndetësore përmes sigurimit të shërbimeve të shëndetit publik, ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik dhe i paketave të informacionit, si dhe i programeve specifike për aksesin në sistemin shëndetësor.

**Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore** (2015-2020), Reforma Territoriale Administrative (2015), Ligji “Për vetëqeverisjen vendore”<sup>21</sup> dhe Ligji “Për financat publike vendore”<sup>22</sup> kanë krijuar bazën dhe hapësirën për reformimin e mëtejshëm të njësive të qeverisjes vendore, riorganizimin administrativ të bashkive mbi bazën e ndarjes së re territoriale, forcimin e financave vendore, zhvillimin ekonomik vendor të qëndrueshëm dhe qeverisjen e mirë në nivel vendor.

### II.3 Strategjitë dhe planet vendore për integrimin e romëve dhe egjiptianëve

Në kuadër të projektit ROMACTED janë hartuar Planet Vendore për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane në gjashtë bashki të përzgjedhura<sup>23</sup> dhe Planit Social në Bashkinë Roskovec. NJVQV-të kanë përcaktuar vizionin dhe objektivat strategjike për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane për periudhën 2019-2022 mbështetur në vlerësimin e nevojave të tyre. Gjatë hartimit të planeve janë mbajtur në konsideratë kryesisht nevojat në fushën e arsimit, punësimit, strehimit, shëndetit, mbrojtja sociale, por dhe çështje të tjera. Masat e planeve vendore adresojnë ndërhyrje pothuajse në të njëjtat fusha me masat e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, çfarë i'u mundëson NJVQV-ve të harmonizojnë angazhimet në nivel vendor me detyrimet në kuadër të zbatimit të planit kombëtar të veprimit.

Planet vendore janë kostuar mbështetur në bazën e të dhënave nga NJVQV-të, si dhe janë identifikuar burimet e financimit dhe hendeuku financiar. Për çdo masë/aktivitet janë përcaktuar treguesit e rezultateve, çka i'u vjen në ndihmë NJVQV-e,

20 si “Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA), “Strategjia e Zhvillimit të Arsimit parauniversitar”

21 Ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

22 Ligji 68/2017 “Për Financat Vendore”

23 Bashkia Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Përmet, Pogradec



që të planifikojnë ndërhyrje në fusha të caktuara duke mbajtur në konsideratë këta tregues.


Plane veprimi për zhvillimin e komunitetit rom dhe egjiptianë janë hartuar dhe nga disa njësi të tjera vendore<sup>24</sup>. Nevojat që adresohen në këto plane mbulojnë kryesisht të njëjtat fusha, por zbatimi i tyre përfshin periudhën 2016-2020.

Ndërsa 24 NJVQV kanë hartuar plane sociale vendore, të cilat janë zhvilluar për grupe dhe fusha të ndryshme si për mbrojtjen e fëmijëve, pakicën rome, barazinë gjinore, planet e shërbimeve sociale, etj<sup>25</sup>.

24 Bashkia Shkodër, Berat, Tiranë, Durrës

25 Draft Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2019-2022, fq.22





## **III. Përse duhen përfshirë nevojat e pakicave rome dhe egjiptiane në buxhet?**

Afërsia e pushtetit vendor në jetën e përditshme të njerëzve do të thotë që ato kanë mundësi të përgjigjen më drejtpërdrejt ndaj nevojave të pakicave rome dhe egjiptiane kur bëhet fjalë për politika publike dhe ofrimin e shërbimeve. Në këtë nivel qeverisjeje, ekziston një potencial i madh për të përdorur buxhetimin e përgjigjshëm për romët duke përfshirë popullsinë vendore.

### **III.1 Hendeku midis politikave dhe buxhetit për nevojat e pakicave**

Në teorinë e Financave Publike pranohet gjerësisht që gjithmonë ekziston një hendek mes mënyrës se si qeveritë (qendrore dhe vendore) planifikojnë, si ato i miratojnë dhe zbatojnë politikat dhe mënyrës se si i buxhetojnë/financojnë këto politika. Hartimi dhe miratimi i politikave që rritin aksesin e romëve dhe egjiptianëve në programet sociale të strehimit, që fëmijët e këtyre pakicave të gëzojnë mundësi të barabarta për t'u arsimuar dhe për një arsim cilësor, apo që romët dhe egjiptianët të përfshihen në skemat e nxitjes së punësimit është një gjë. Ndërsa të parashikosh fonde në buxhet në mënyrë që këto politika të financohen e të bëhen të realizueshme është tjetër gjë.

Hendeku midis miratimit të politikave dhe hartimit të buxhetit është vënë re në të gjithë sektorët dhe në të dy nivelet e qeverisjes. Për të ngushtuar këtë hendek ka disa vite që realizohet kostimi i dokumentave politikë, proces ky që identifikon kostot për zbatimin e politikave, mbështetur kjo në tregues të matshëm sasior; burimet e financimit të këtyre politikave dhe llogaritjen e hendekut financiar. Kostimi i strategjive dhe planeve të veprimit u mundëson institucioneve, që të parashikojnë nevojat financiare që kanë për zbatimin e politikave ekzistuese dhe ato për zbatimin e politikave të reja.

Në të dy nivelet e qeverisjes dhe në sektorë të ndryshëm mund të gjenden shembuj, se si nuk janë vënë në zbatim politika të ndryshme që synojnë pakicat rome dhe egjiptiane, apo se si ato vihen në zbatim vetëm pjesërisht, ngaqë gjatë procesit të planifikimit të buxhetit nuk është bërë si duhet shqyrtimi i burimeve buxhetore dhe jo buxhetore në dispozicion.



## III.2 Integrimi i perspektivës rome dhe egjiptiane në buxhet si faktor për fuqizimin e pakicave

Edhe pse romët dhe egjiptianët e kanë fituar de jure barazinë përmes legjislacionit për luftën kundër diskriminimit dhe për nxitjen e mundësive të barabarta, shumë anëtarë të këtyre pakicave ende nuk përjetojnë barazi të qenësishme në jetën e përditshme. Për të arritur një barazi de facto, nevojitet një qasje ndryshe.

Buxhetimi i përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët pranon që këto pakica kanë marrëdhënie të ndryshme me ekonominë. Po ashtu, kjo ka të bëjë edhe me faktin se nëse duam të arrijmë progres të qenësishëm për integrimin, politikat pa buxhetet nuk mjaftojnë. Buxhetimi i përgjigjshëm kërkon që buxhetet t'u përgjigjen më mirë nevojave të romëve dhe egjiptianëve.

Logjika mbi të cilën mbështetet buxhetimi i përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët është se, si të gjitha politikat shtetërore, buxheti i prek ndryshëm grupet e ndryshme shoqërore për shkak të nevojave, kushteve ekonomike dhe roleve të tyre në shoqëri. Synimi i buxhetimit të përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët është të sigurojë që masat e buxhetit të NJVQV-e (si nga ana e shpenzimeve, ashtu edhe nga ana e të ardhurave të buxhetit) të marrin në konsideratë nevojat e këtyre pakicave; dhe të sigurojnë që buxheti kontribon në zvogëlimin e pabarazisë; dhe ofron shërbime publike në mënyrë që ato të fuqizohen.

## III.3 Përfitimet nga zbatimi i buxhetimit të përgjigjshëm për pakicat rome dhe egjiptiane

Buxhetimi i përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët mbart në vetvete potenciale të rëndësishme dhe avantazhe të shumta. Zbatimi i buxhetimit të përgjigjshëm:

- **angazhon komunitetin në procesin e buxhetimit.** Sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë në procesin e buxhetimit është një parakusht kryesor në të gjithë këtë proces. Për më tepër, qeverisja e mirë përmirësohet me ndihmën e një procesi transparent të zhvillimit të politikave vendore me një pjesëmarrje të gjerë të komunitetit. Zbatimi i buxhetit të përgjigjshëm është i lidhur drejtpërdrejt me respektimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut. Marrëdhëniet me pakicat varen plotësisht nga respektimi i të drejtave të njeriut. Kjo përcaktohet nga një sërë faktorësh objektivë socio-ekonomikë dhe politikë. Në Shqipëri, si një vend në tranzicion dhe me një nivel të ulët të zhvillimit ekonomik, ekziston barazia formale: domethënë mundësitë e barabarta për grupet e marginalizuara kodifikohen de jure, por de facto nuk





ka burime financiare të mjaftueshme për të zbatuar masa specifike, që do të çonin në fuqizimin e tyre.

- **rrit cilësinë e programeve dhe shërbimeve për këto pakica.** Buxhetimi i përgjigjshëm synon të masë hendekun midis angazhimeve të ndërmarra përmes politikave dhe planifikimit të burimeve, si dhe rezultateve të arritura nga zbatimi i politikave. Me ndihmën e kësaj qasjeje, këndvështrime të ndryshme të grupeve të marginalizuara paraqiten në të gjitha fazat e hartimit dhe zbatimit të buxhetit. Procesi për të përmirësuar shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve në një mënyrë të drejtë dhe të përgjigjshme për komunitete të ndryshme mundëson një akses më të madh dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.
- **rrit efektivitetin e shpenzimeve publike.** Zbatimi i buxhetimit të përgjigjshëm tërheq vëmendjen e NJVQV-ve për nevojat e pakicave rome dhe egjiptiane dhe analiza e bazuar në përfitimet e drejtpërdrejta të pakicave kontribon në marrjen e informacionit më të plotë për shpërndarjen e burimeve midis përfituesve prej pjesës më të madhe të popullsisë dhe grupeve në nevojë, si dhe ndihmon në përcaktimin e ndikimit që kanë politikat dhe shpenzimet publike në përmirësimin e jetës së tyre. Kjo qasje siguron gjithashtu një bazë më të mirë, më të bazuar në evidenca për vendimmarrësit dhe për këtë arsye do të kontribuojë për t'u siguruar që fondet publike të përdoren në mënyrë më efektive.
- **Përmirëson kuadrin ligjor e politik.** Identifikimi i pabarazive midis pakicave dhe pjesës tjetër të popullsisë dhe qasja për adresimin e tyre do të diktojë propozimin e ndryshimeve në legjislacion dhe hartimin e politikave të reja, e cila përbën një hap të rëndësishëm për ngushtimin e pabarazive.
- mund të shërbejë gjithashtu dhe si një mjet për të **përmirësuar efektivitetin** e ndihmës së huaj dhe fondeve të sektorit jofitimprurës në favor të pakicave. NJVQV-të përfitojnë shërbime dhe investime në kuadër të projekteve të financuara nga donatorë të ndryshëm dhe të zbatuara nga organizata ndërkombëtare dhe vendore. Bashkitë planifikojnë shpesh herë në buxhetin e tyre fonde për bashkëfinancimin e projekteve. Parashikimi në buxhet i fondeve që përfitohen në kuadër të programeve/projekteve për pakicat rome dhe egjiptiane nga burime të tjera do të mundësonte rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve për pakicat.



### III.4 Rritja e llogaridhënies dhe transparencës në hartimin e buxhetit

Buxhetimi i përgjigjshëm është një mjet i fuqishëm për të nxjerrë në pah hendekun midis angazhimeve kombëtare dhe vendore për integrimin e romëve dhe egjiptianëve dhe sasinë e fondeve publike të caktuara për realizimin e këtyre angazhimeve, arritjen e standardeve dhe objektivave të integritit. Duke gjurmuar sa para janë planifikuar dhe si shpenzohen ato, buxhetimi i përgjigjshëm rrit njëkohësisht llogaridhënien dhe transparencën. Për më tepër, buxhetimi i përgjigjshëm promovon disponueshmërinë e të dhënave të ndara sipas moshës dhe gjinisë, plus qasjen në evidenca të ndryshme rreth programeve dhe buxhetit në përgjithësi.

### III.5 Praktikat e mira për përfshirjen e romëve në vendet e BE-së

Romët janë pakica më e madhe etnike e Evropës, e cila vlerësohet të jetë rreth 10-12 milion. Situata e tyre në disa vende të BE-së mbetet kritike pasi ata vazhdojnë të përballen me diskriminim dhe qasje të pabarabartë në shërbime jetësore. Pjesa më e madhe e romëve ka më shumë të ngjarë të jenë të papunë dhe jetojnë në varfëri në krahasim me popullsinë jo-rome. Kjo situatë i kufizon shanset e tyre për të përfituar një arsim të mirë dhe për të patur një strehim të përshtatshëm. Ata shpesh jetojnë në kushte të pasigurta me qasje të pakët në shërbimet bazë<sup>26</sup>.

Sipas raportit të "EUROCITIES"<sup>27</sup> bashkitë përdorin mënyra të ndryshme në përpjekjet e tyre për integrimin e romëve në nivelin vendor. Në varësi të burimeve që ata disponojnë (kryesisht atyre njerëzore dhe financiare), bashkitë mund të adoptojnë qasje të synuara ndaj sfidave me të cilat përballen romët. Nëpër qytete, një prirje e përbashkët është të zbatohen nisma të shumta dhe plotësuese për përfshirjen e romëve në nivelin vendor.

Qasja më e zakonshme midis autoriteteve vendore është të miratojnë politika të synuara për të përmirësuar jetën e romëve në fusha të veçanta, të tilla si arsimi, punësimi ose strehimi. Shumë bashki gjithashtu kanë hartuar strategji vendore

26 Mapping\_of\_the\_situation\_of\_Roma\_in\_cities\_(FINAL\_REPORT), fq. 3

27 Raporti "EUROCITIES" analizon situatën e përfshirjes së romëve në nivelin vendor, sfidat me të cilat përballen romët në 23 qytete Evropiane në lidhje me punësimin, strehimin, kujdesin shëndetësor, arsimin dhe shërbimet bazë. Raporti gjithashtu eksploron se si qytetet reagojnë ndaj këtyre sfidave, çfarë nismash ata vendosin, si angazhohen me romët dhe për çfarë mbështetje ata kanë nevojë për të qenë në gjendje të integrojnë më tej përfshirjen e romëve.



ose plane veprimi për integrimin rom. Më shumë se një e treta e qyteteve kanë ndërmarrë nisma ose zbatuar projekte për të përmirësuar aksesin e romëve në shërbime publike<sup>28</sup>.

Më poshtë paraqiten disa shembuj të praktikave të mira nga nismat e qyteteve evropiane<sup>29</sup>.

- Më shumë se gjysma e qyteteve<sup>30</sup> kanë një strategji vendore për integrimin rom, e cila në shumë raste ndjek kornizën e vendosur në nivelin e BE-së. Qytetet e tjera që nuk kanë një strategji specifike për romët, parashikojnë përfshirjen rome në strategjinë e tyre vendore kundër varfërisë dhe përjashtimit.

Barcelona ka një "Strategji vendore për romët" miratuar në Mars 2015. Strategjia ka 88 masa në gjashtë fusha kryesore, nga të cilat katër janë të njëjta me Kornizën e BE-së për romët (arsim, punësim, strehim dhe kujdes shëndetësor) dhe dy janë të reja (trajnimi i profesionistëve në praktikat jodiskriminuese dhe fuqizimi i kulturës rome). Zbatimi filloi në 2016/7, me financim bashkiak prej 420.000 €.

- Shumë nisma janë ndërmarrë nga bashkitë për të rregulluar situatën e strehimit rom. Disa nga nismat e raportuara më shpesh janë: (i) strehëzat për romët shoqëruar me mbështetje të shërbimeve sociale (zgjdhje afatshkurtra të qëndrimit); (ii) këshillimi ligjor për mundësitë në tregun e rregullt të banesave dhe për të drejtat e qiramarrësve; (iii) projektet e blerjes dhe rinovimit të banesave (bashkia blen prona private); (iv) projekte strehimi për rehabilitimin e hapësirave publike të papërdorura ose të braktisura (strehimi social)<sup>31</sup>.

Në Glasgow, programi i blerjes së banesave u iniciua për të trajtuar kushtet e këqija të banesave në një lagje me një densitet të lartë të romëve të sapo ardhur. Programi dy-vjeçar përfshin blerjen dhe rinovimin e pronave, që kryesisht janë të okupuara nga romët dhe janë në pronësi të pronarëve privatë. Këshilli i qytetit në Glasgow dhe qeveria skoceze parashikuan 13 milion £ për skemën pilot. Pas suksesit të fazës pilot, skema u zgjat për 4 vitetë tjera me financim prej 40 milion £.

28 Po aty fq.30

29 Po atyfq. 30-32

30 23 qytete të përfshira në studim

31 Po aty, fq.21



- Disa qytete kanë adoptuar një qasje të integruar për përfshirjen e romëve në qytetin e tyre. Ato zbatojnë programe shumëdimensionale për të adresuar sfidat e shumëfishta të varfërisë dhe përjashtimit të romëve.

Grenoble ka krijuar një qasje të integruar për përfshirjen e romëve dhe migrantëve. Njerëzit që jetojnë në kushte të pasigurta, marrin mbështetje për strehim, kujdes shëndetësor, arsim dhe futje në punë. Për shembull, familjeve u sigurohet strehim i përkohshëm së bashku me mbështetje për të hyrë në punë dhe për të marrë akomodimin e tyre jo të përkohshëm.


- Disa qytete kanë krijuar programe për trajnimin e stafit në administratën e tyre për të punuar me romët. Shpesh fokusi i trajnimit është aksesimi jodiskriminues në shërbime.

Bashkia e Dortmundit ka zhvilluar një program studimi bachelor të dyfishtë në punën sociale, me fokus në varfërinë dhe migracionin në bashkëpunim me Universitetin e Shkencave të Aplikuara. Studentët janë trajnuar të ofrojnë punë sociale me refugjatë dhe migrantë, siç janë romët, dhe të bëhen "ndihmësit e integrit". Programi ndjek modelin e trajnimit të dyfishtë me 50% të kohës së kaluar për të studiuar në kurse universitare dhe 50% të mësimin në punë si punonjës social në sektorin publik, privat ose OJF.

Shumica e nismave për përfshirjen e romëve në nivelin vendor financohen nga buxhetet bashkiake ndërsa një pakicë merr gjithashtu disa fonde kombëtare ose të BE-së. Pothuajse gjysma e qyteteve (10 nga 23) kanë një buxhet të ndarë posaçërisht për përfshirjen e romëve. Kjo u lejon atyre të financojnë nismat e qytetit të tyre për t'iu përgjigjur sfidave me të cilat përballen romët, si dhe të japin mbështetje për aktivitetet e zhvilluara nga organizatat rome. Në përgjithësi, qytetet që kanë një strategji vendore të integritit rom kanë gjithashtu një buxhet të ndarë për të mbështetur zbatimin e tij. 12 qytetet e tjera financojnë punën e tyre për përfshirjen rome duke programuar fonde nga buxheti bashkiak për përfshirjen e grupeve të marginalizuara ose buxheti i tyre i përgjithshëm për shërbime sociale apo edhe buxhetet specifike për arsim ose shëndetësi.<sup>32</sup>

<sup>32</sup> Po aty, fq. 33





## Hapat për integrimin e nevojave/ prioriteteve të pakicave romë dhe egjiptiane në buxhetin vendor

### IV.1 Hartimi i buxhetit të përgjigjshëm vendor me perspektivën e pakicave

Të gjithë aktorët në nivel vendor duhet të kuptojnë që buxheti i përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët nuk ka të bëjë vetëm me buxhetin. Procesi i buxhetimit të përgjigjshëm duhet së pari të fillojë me përfshirjen e nevojave të këtyre pakicave në të gjitha politikatat, programet dhe planet që ndikojnë vendimet për miratimin e buxhetit. Hartimi i "Planeve Vendore për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve" dhe i Planeve Sociale në disa njësi vendore është një hap në drejtimin e duhur. Natyrisht që kjo qasje duhet të mbahet në konsideratë dhe nga bashki të tjera. Ndërkohë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe ministrinë e tjera, që kanë përgjegjësi për adresimin e nevojave të romëve dhe egjiptianëve duhet të përfshijnë në udhëzimet e tyre reflektimin e përparësive për këto pakica në programet buxhetore.

Puna për hartimin e buxhetit të përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët kalon në tri faza kryesore, të cilat janë<sup>33</sup>: (i) Analiza e politikave dhe buxhetit nga perspektiva e pakicave; (ii) realizimi i ndryshimeve në programe dhe buxhete bazuar në rezultatet e analizës së buxhetit në mënyrë që ta bëjë atë më të ndjeshëm për romët dhe egjiptianët; (iii) Integrimi i buxhetit të përgjigjshëm për pakicat në mënyrë sistematike në procesin e planifikimit dhe buxhetimit vendor (figura 1). Njohja dhe përballja me situatën, integrimi i buxhetit të përgjigjshëm për pakicat në procesin e planifikimit dhe buxhetimit do të sigurojë kushtet për një analizë sistematike dhe të vazhdueshme të politikave dhe buxheteve nga perspektiva e romëve dhe egjiptianëve, e cila do të pasojë, nëse është e nevojshme, me përshtatje të politikave dhe buxheteve.

Të gjitha fazat janë njëllor të rëndësishme dhe janë të ndërthurura ngushtë me njëra tjetrën, por ato nuk duhen parë si faza të njëpasnjëshme. Puna për hartimin e buxhetit mund të fillojë ose nga analiza ose nga integrimi sistematik i BP për pakicat në procesin e planifikimit dhe buxhetimit. Megjithatë duhet theksuar që BP i përfshin të gjitha fazat.

33 Përshatur nga GRB manual for Municipalities, UN Women 2015, fq. 50-66



**Figura 1: Fazat kryesore të punës për hartimin e buxhetit të përgjigjshëm për pakicat**



**Analiza e politikave dhe buxhetit** nga perspektiva e pakicave për të krijuar një bazë të mirë për aktivitetet e mëtejshme, që synojnë përmirësimin e situatës së romëve dhe egjiptianëve. Për të realizuar një analizë sistematike rekomandohen disa hapa. Kjo qasje mund të zbatohet në shumë fusha, megjithatë, mund të ndryshojë disi në detaje sipas fushës ose sektorit për të cilat bëhet analiza specifike.

Pyetjet kryesore që duhet të marrin përgjigje gjatë analizës janë: Cili është ndikimi i politikave dhe buxheteve përkatëse në integrimin e pakicave romë dhe egjiptiane? A ndikon zbatimi i politikave në uljen, rritjen e pabarazive apo ato nuk kanë ndikim fare? Hapat kryesorë për të realizuar analizën janë:

- Hapi 1: Mbledhja e informacionit (të dhënave) rreth politikave dhe programeve;
- Hapi 2: Identifikimi i nevojave të romëve dhe egjiptianëve në secilin sektor;
- Hapi 3: Analiza nga këndvështrimi i pakicave romë dhe egjiptiane e të gjithë aktiviteteve;
- Hapi 4: Analiza nga këndvështrimi i pakicave Rome dhe Egjiptiane i buxheteve të miratuara;
- Hapi 5: Hartimi i rekomandimeve.

**Mbledhja e informacionit rreth politikave dhe programeve** - Hapi i parë është të qartësoni se çfarë doni të analizoni. A doni të analizoni një sektor, një program specifik, një shërbim specifik publik, investim apo transferim të parave në cash. Hapat në të cilat duhet të kalojë analiza janë fleksibël dhe mund të përshtaten mbështetur në fokusin e analizës. Nëse doni të analizoni një sektor (p.sh. shërbimet publike vendore, arsimin parauniversitar), analiza do të jetë pak më komplekse sepse shumë shërbime dhe investime të ndryshme, etj., mund të përfshihen dhe do të duhet të bëhen më të detajuara ose specifike.

Për të sqaruar hapat do të marrim parasysh një program<sup>34</sup>. Një hap i parë i rëndësishëm është të mblidhen të gjitha të dhënat e rëndësishme për programin dhe të keni një pamje të plotë të tij. Nëse jeni nëpunësi përgjegjës për programin, kjo do të jetë një

<sup>34</sup> Hapat janë të njëjtë dhe fjala program mund të zëvendësohet me sektor, shërbim specifik dhe investim



detyrë e lehtë. Kjo përfshin përgjigjen e pyetjeve të mëposhtme:

- Cilat janë objektivat e programit ?
- A ka objektiva specifike në lidhje me integrimin e pakicave ose synimeve të orientuara posaçërisht në përmirësimin e situatës së romëve dhe egjiptianëve?
- Cilat janë aktivitetet kryesore brenda programit?
- Si mund të kontribuojë programi në arritjen e integritit të romëve dhe egjiptianëve? Sa buxhet është i disponueshëm për programin dhe për cilat aktivitete shpenzohet?

**Identifikimi i nevojave të romëve dhe egjiptianëve** - në këtë hap duhet të analizohet situata e romëve dhe egjiptianëve në sektorin specifik. Synimi i analizës është të bëhet një përmbledhje e situatës së pakicave në programin specifik, për të evidentuar nevojat dhe përparësitë e tyre, të cilat duhet të adresohen nga politikat publike. Për shembull, nëse analizoni programin e strehimit, do të përqendroheni në situatën e romëve dhe egjiptianëve në lidhje me strehimin, p.sh. numri i familjeve që banojnë në kushte të papërshtatshme strehimi (baraka ose kasolle), numri i familjeve të pastreha, në cilat njësi administrative janë të vendosur, sa përqind e tyre banojnë në banesa që nuk kanë akses në ujin e pijshëm dhe kanalizimet, sa përqind banojnë në ndërtesa informale, etj.

Për këtë hap, mund të përdorni të dhëna sasiore, por edhe informacion cilësor të disponueshëm nga burime të ndryshme, p.sh. nga burime të departamentit përkatës përgjegjës për programin në bashki, nga të dhënat e INSTAT-it (p.sh të dhënat e censusit), nga raporte kërkimore ose studime të ndryshme të realizuara nga akademikë, institucione të tjera kërkimore, organizata ndërkombëtare dhe vendore, etj. Informacioni mund të sigurohet gjithashtu duke kontaktuar ekspertë të sektorit, njerëz që e njohin mirë situatën e tyre, p.sh. ofruesit e shërbimeve, përfaqësuesit e lagjeve ose përfaqësuesit e zgjedhur. Në rastet kur ka shumë pak informacion në dispozicion, dhe nëse është e mundur dhe e përshtatshme, mund të organizoni takime me përfaqësues të pakicave për të mësuar më shumë rreth situatës së tyre.

Disa pyetje kryesore këtu janë:

- Cila është situata e romëve dhe egjiptianëve (dhe e nëngrupeve grave/burrave, të rinjve dhe të moshuarve) në sektorin e analizuar?
- Cilat janë interesat, nevojat dhe përparësitë e tyre?
- A ka nevoja që duhet të merren parasysh?
- Cilat janë pabarazitë ekzistuese midis pjesës më të madhe të popullsisë dhe pakicave rome dhe egjiptiane?



- Cilat janë sfidat kryesore në lidhje me integrimin e pakicave në sektor?

Bazuar në analizën e të dhënave, identifikoni çështjet kryesore të romëve dhe egjiptianëve që duhet të adresohen nga politikat vendore. Në këtë mënyrë mund të përcaktohen objektiva specifike, që mund të kontribuojnë në integrimin dhe fuqizimin e pakicave në sektorin ose programin specifik.

### **Analiza nga perspektiva e pakicave rome dhe egjiptiane e të gjitha aktiviteteve**

- mbështetur në analizën e përgjithshme të programit dhe e të dhënat e mbledhura në lidhje me situatën e grupit të synuar, mund të bëni një analizë nga perspektiva e pakicave duke përdorur instrumente të ndryshme analitike.

- *Analiza e përfituesve dhe përdoruesve të shërbimeve publike* (p.sh. sa familje rome dhe egjiptiane kanë përfituar bonus qeraje, sa familje kanë përfituar nga investimet për përmirësimin e kushteve të banimit, sa është numri i familjeve rome që përfitojnë nga programi i ndihmës ekonomike, etj.) Nëse programi nuk ka përfitues të drejtpërdrejtë, sepse është një program i përqendruar në investime si transporti, pyetjet që mund t'iu japim përgjigje janë: *A kanë romët akses në transportin publik? A ka pengesa të mundshme që nxënësit romë dhe egjiptianë të mund të përdorin këtë shërbim? A ofrohen shërbime specifike për këtë kategori?*
- *Analiza e kënaqësisë së përdoruesve të shërbimeve publike* - NJVQV-të duhet të analizojnë nëse romët dhe egjiptianët janë të kënaqur me cilësinë dhe sasinë e aktiviteteve të ofruara (p.sh. menaxhimin e mbetjeve, infrastrukturën, furnizimin me ujë të pijshëm, kujdesin shoqëror, etj.). Disa nga metodat për të tërhequr mendimin e përfituesve janë pyetësorët, diskutimet në grup dhe vrojtimet e realizuara nga OJF-të. Disa nga pyetjet që mund të bëjmë janë: *Sa të kënaqur janë romët dhe egjiptianët me cilësinë e shërbimeve të ofruara? A e përmbush kërkesën e tyre sasia e shërbimeve të ofruara? A përputhen shërbimet me nevojat e romëve dhe egjiptianëve?*
- *Analiza e vendimmarrjes* - bashkitë duhet të analizojnë procesin e vendimmarrjes në lidhje me nevojat e pakicave. *Si përcillen në organet vendimarrëse në bashki? A janë romët dhe egjiptianët të përfaqësuar në Këshillin Bashkiak? Kush ka ndikim në vendimarrje për programe dhe shërbime që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me integrimin e pakicave?*

### **Analiza nga perspektiva e pakicave rome dhe egjiptiane e buxheteve të miratuara**

- analiza e përdoruesve dhe përfituesve është e ndërthurur me analizën e buxhetit. Kjo mund të realizohet duke vlerësuar nëse buxheti i planifikuar për të zbatuar programin merr në konsideratë nevojat e romëve dhe egjiptianëve. Kjo përfshin analizimin e nevojave të ndryshme dhe shikohet nëse programi u përgjigjet nevojave të ndryshme duke ofruar shërbime specifike. Disa nga pyetjet që mund të





bëhen janë: A është buxheti në dispozicion i mjaftueshëm për të zbatuar programin duke pasur parasysh numrin e përfituesve në grupin e synuar? A është buxheti në dispozicion i mjaftueshëm për të siguruar shërbime dhe aktivitete që i përgjigjen nevojave të romëve dhe egjiptianëve? Sa ka qenë buxheti për programin gjatë vitit të kaluar? A ka pasur rritje apo ulje? A janë shpenzuar plotësisht paratë e planifikuara në buxhet për zbatimin e programit?

**Hartimi i rekomandimeve** për të adresuar nevojat e romëve dhe egjiptianëve brenda programit bazuar në rezultatet e analizës. Në këtë fazë është e rëndësishme që rekomandimet të jenë sa më konkrete dhe të përcaktohen aktivitete, që adresojnë nevojat e identifikuar. Disa nga pyetjet janë: *Cilat janë nevojat që duhen adresuar? Cilat objektiva specifike duhet të përfshihen në programet përkatëse? Cilat ndryshime në aktivitete janë të nevojshme për të përmbushur më mirë objektivat specifike? Cilat ndryshime mbi buxhetet e planifikuara janë të nevojshme për të përmbushur më mirë objektivat?* Në këtë fazë rekomandohet gjithashtu të përcaktohen treguesit për të matur progresin në arritjen e objektivave.

**Përfshirja e nevojave të romëve dhe egjiptianëve në politikat dhe programet buxhetore** arrihet duke reflektuar në politikat vendore, rekomandimet dhe ndryshimet e nevojshme të aktiviteteve, programeve ose planeve, bazuar në analizën e sektorëve, si dhe ndryshimet në buxhet.

Hapi 6: Riformulimi i politikave dhe ndryshimet në buxhet;

Hapi 7: Monitorimi dhe vlerësimi i procesit.

Një komponent thelbësor i punës për buxhetin e përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët është të kalosh nga analiza drejt **ndryshimit** të politikave, aktiviteteve dhe burimeve për të arritur rezultatet e dëshiruara. Bazuar në rekomandimet është e nevojshme të identifikohet se çfarë duhet të ndryshohet, në cilën fazë të planifikimit dhe buxhetimit dhe kush është përgjegjës brenda bashkisë për të punuar për ndryshimet. Ndryshimet dhe përshtatjet mund të jenë të nevojshme në lidhje me aspekte të ndryshme, siç janë politikat, programet ose aktivitete specifike të sektorit, si dhe fondet që duhet të planifikohen në buxhetin e vitit të ardhshëm ose në buxhetin afatmesëm.

Bazuar në treguesit e rezultateve dhe treguesit që matin zbatimin e aktiviteteve dhe buxheteve të planifikuara, mund të krijohet një **mekanizëm monitorimi** për zbatimin e politikave për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane. Një grup i veçantë treguesish mund të identifikohet në sektorë të veçantë për të organizuar një monitorim specifik.

Fazë e tretë ka të bëjë me **integrimin sistematik të buxhetit të përgjigjshëm** për pakicat në procesin e planifikimit dhe buxhetimit. Zbatimi i buxhetit të përgjigjshëm për pakicat rome dhe egjiptiane në bashki ka për qëllim të sigurojë që perspektiva



e marrjes parasysh të nevojave të pakicave është plotësisht e integruar në proceset e planifikimit dhe buxhetimit për t'i bërë ato më të përgjigjshme. Qëllimi është të kemi një analizë sistematike të politikave dhe buxheteve nga perspektiva e pakicave në të gjithë sektorët. Kjo nuk do të thotë që duhet të analizohet çdo aktivitet apo zë shpenzimesh në bashki, por se në të gjithë sektorët duhet të bëhen analiza nga perspektiva e pakicave për programet dhe politikat kryesore.

Buxheti i përgjigjshëm me perspektivën e pakicave kërkon përfshirjen e të gjithë departamenteve kryesore të bashkisë dhe të gjithë sektorëve. Buxheti i përgjigjshëm nuk është çështje vetëm për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale ku nevojat e romëve dhe egjiptianëve mund të jenë më të dukshme. Në përgjithësi, supozohet se në të gjithë sektorët nevojat e pakicave romë dhe egjiptiane janë me rëndësi dhe janë të identifikuar, dhe do të ketë vetëm disa sektorë, ku nuk do të gjejmë një lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të programit buxhetor me përfshirjen romë. Pra, është e rëndësishme që të gjitha departamentet duhet të punojnë për të përfshirë perspektivën e pakicave në planifikim dhe buxhetim.

Së fundi, por shumë e rëndësishme, buxhetimi i bazuar në performancë ofron shumë mundësi për të zbatuar buxhetin e përgjigjshëm me perspektivën e pakicave.

## IV.2 Kategorizimi i programeve buxhetore sipas perspektivës së pakicave

Përpara se të formulohen objektivat për integrimin e romëve dhe egjiptianëve dhe të bëhet një analizë e thelluar për buxhetimin e përgjigjshëm, shpenzimet mund të kategorizohen në linja buxheti në lidhje me qëllimin dhe rëndësinë për integrimin e këtyre pakicave. Disa programe buxhetore kanë një ndikim të dukshëm ose të mundshëm në integrimin rom dhe egjiptian. Nga ana tjetër, ka programe buxhetore që ndikojnë në rastin më të mirë në mënyrë të tërthortë ose që nuk kanë një ndikim të prekshëm.

Mbështetur në përvojën ndërkombëtare dhe praktikata e ndjekura për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor kategorizimi i programeve buxhetore mund të realizohet me metoda të ndryshme. Më poshtë përshkruhen dy metoda të përdorura për klasifikimin e programeve buxhetore.

(i) *metoda sipas shkallës G+<sup>35</sup>*, e cila mbështetet në një sistem klasifikimi, që i jep përparësi programeve buxhetore që kanë ndikim më të madh në integrimin e pakicave. Kriteret që mund të përdoren për të zgjedhur programet janë: të ketë një

35 Rasti i Andalusia; për më shumë shih Quinn. SH Gender Budgeting: practical implementation; CoE 2009, fq.21



kapacitet transformues; të ketë aftësinë për të ndikuar në një shkallë të gjerë dhe të ketë aftësi për të zvogëluar pabarazinë. Sipas shkallës së ndikimit programet mund të klasifikohen si programe me ndikim:

- **të ulët (g<sub>1</sub>):** Në këtë kategori mund të përfshihen ato programe që kanë ose nuk kanë ndikim fare. Për rastet kur nuk ka ndikim klasifikohen ato programe që nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë tek personat ose kanë një efekt të tërthortë të ulët. Në rastet kur ka ndikim përfshihen programet që ndikojnë mbi njerëzit në nivel minimal.
- **të mesme (G):** këtu përfshihen programet me ndikim të ulët, me kapacitete transformuese të kufizuara ose rëndësi funksionale të ulët.
- **të lartë (G<sup>+</sup>):** programet me interes të madh për shkak të aftësisë së tyre transformuese, ndikimit dhe funksioneve të njohura.

(ii) metoda e kategorizimit të zërave të shpenzimeve sipas mënyrës së lidhjes me përfshirjen<sup>36</sup>. Për këtë qëllim mund të përdoret kategorizimi i programeve të buxhetit sipas "Udhëzimit për Buxhetimin e Përgjigjshëm Rom:<sup>37</sup>

- Kategori 1: Programe të lidhura drejtpërdrejt me përfshirjen rome
- Kategori 2: Programe të lidhura në mënyrë të tërthortë me përfshirjen rome
- Kategori 0: Programe të palidhura me përfshirjen rome

Kategorizimi i programeve buxhetore sipas të dyja metodave nuk e ndryshon klasifikimin e programeve. **Metoda e dytë rekomandohet të përdoret nga NJVQV-të, pasi krijon një lidhje midis programeve buxhetore të nivelit qendror me programet buxhetore të bashkive.** Më poshtë analizohet kategorizimi i disa programeve buxhetore mbështetur në lidhjen e programit me përfshirjen e pakicave.

Kategorizimi i programeve specifike buxhetore mund të shpjegohet si më poshtë.

- **Strehimi social** nënkupton administrimin dhe planifikimin e programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm. Ky është shembulli i një programi buxhetor, që lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e politikave për përfshirjen rome, sepse ligji për strehimin social parashikon disa programe si: bonus i qerasë; projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara; programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin; ndërtimi i strehave tranzitore të cilat mund të financohen nga NJVQV-të, fonde të buxhetit të shtetit dhe të donatorëve dhe që ndikojnë

36 Rasti i Austrisë; për më shumë shih Guidance Gender Budgeting in Public Administration;

37 RCC, Guidelines for Roma Responsive Budgeting, fq. 15



në mënyrë të drejtpërdrejtë në kushtet e banimit të pakicave rome dhe egjiptiane.

- **Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor** siguron ndërtimin dhe mirëmbajtjen e strukturave shkollore dhe parashkollore. Ky program buxhetor lidhet drejtpërdrejt me politikën për rritjen e aksesit të pakicave rome dhe egjiptiane në sistemin arsimor pasi synon krijimin e kushteve optimale përmes rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së godinave, aktivitete për qendrat kulturore të fëmijëve, aktivitete të ndryshme jashtëshkollore, etj.
- **Shërbimet vendore të ujësjellësit** mbulon sigurimin me ujë të pijshëm për banorët dhe bizneset në territorin e NJVQV-ve. Pëmes këtij programi realizohet mirëmbajtja ose përmirësimi i sistemeve të furnizimit me ujë. Ky program mund të konsiderohet si një program buxhetor i lidhur në mënyrë të tërthortë me zbatimin e politikave për përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve. Nëse NJVQV-të identifikojnë projekte, që synojnë drejtpërdrejt këto pakica si: subvencionimi i tarifës së lidhjes së kontratës dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë<sup>38</sup>; ose rikonstruksioni i rrjetit të ujësjellësit në vendbanimet rome atëherë ai mund të konsiderohet si një program buxhetor, që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë.
- **Kujdesi social për familjet dhe fëmijët** mbulon ofrimin e mbështetjes në para dhe në natyrë, për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet, fëmijët dhe personat e margjinalizuar. Ky program buxhetor lidhet drejtpërdrejt me politikën për përmirësimin e përfshirjes së pakicave rome dhe egjiptiane në programet e mbrojtjes sociale.
- **Planifikimi Urban Vendor** mbulon marrjen e masave për planifikimin dhe zhvillimin e banesave të përshtatshme në njësinë vendore. Në kuadër të këtij programi bëhet zhvillimi, përditësimi, bashkërendimi dhe monitorimi i planeve të zhvillimit urban; lëshimi i lejeve për ndërtime të reja; sigurimi i truallit të nevojshëm për ndërtime banesash; eliminimi i ndërtimeve të degraduara lidhur me sigurimin e strehimit, etj. Ky mund të konsiderohet si një program i lidhur tërthortazi me përfshirjen rome. Në disa bashki ka vendbanime informale të pakicës rome ose përqendime të tyre në zonat periferike të qyteteve, nevojat e të cilëve duhet të mbahen në konsideratë gjatë hartimeve të planeve urbane dhe planeve të detajuara urbane.
- **Shërbimet e kujdesit parësor** mbulojnë ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor. Ky program mund të konsiderohet me lidhje të drejtpërdrejtë, pasi zbatimi i tij rrit dhe përmirëson



aksesin për popullsinë në tërësi, por në veçanti për grupet e marginalizuara. Përmirësimi i infrastrukturës natyrisht që përmirëson aksesin në shërbim për pakicat rome dhe egjiptiane. Ndërkohë, zhvillimi i aktiviteteve edukuese e promovuese mund të përfshijë vetëm këto 2 pakica ose të gjitha grupet e rrezikuara.

Tabela 1 paraqet kategorizimin e programeve buxhetore në NJVQV-të sipas mënyrës së lidhjes me përfshirjen. Kategorizimi mund të ndryshojë në varësi të objektivave që NJVQV-të kanë përcaktuar në strategjitë e tyre, si dhe aktiviteteve të planifikuara.

**Tabela 1 : Lidhja e programeve buxhetore me përfshirjen e pakicave rome dhe egjiptiane<sup>39</sup>**

Programet Buxhetore	Lidhja me përfshirjen		
	Direkte (1)	E tërthortë (2)	I palidhur (0)
P.1 Planifikimi, menaxhimi, administrimi			0
P.2 Çështje financiare dhe fiskale			0
P.3 Gjendja civile			0
P.4 Pagesa e shërbimit të borxhit të brendshëm			0
P.5 Shërbimet e policisë vendore			0
P.6 Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi			0
P.7 Marrëdhëniet me komunitetin	1		
P.8 Ndihma për zhvillimin ekonomik		2	
P.9 Shërbimi, akreditimi, inspektimi i tregut		2	
P.10 Shërbimet bujqësore, inspektimi dhe siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit			0
P.11 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit			0
P.12 Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave			0
P.13 Sistemi rrugor (rural + urban)		2	
P.14 Transporti publik		2	
P.15 Projektet e zhvillimit		2	
P.16 Zhvillimi i turizmit			0
P.17 Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave	1		
P.18 Menaxhimi i ujërave të zeza dhe i kanalizimeve		2	

39 Lista e 36 programeve të paraqitura nga MFE-ja për pushtetin vendor



P.19 Programet për mbrojtjen e mjedisit			0
P.20 Ndërgjegjësimi mjedisor			0
P.21 Planifikimi urban vendor		2	
P.22 Programet e zhvillimit		2	
P.23 Shërbimet publike vendore		2	
P.24 Furnizimi me ujë të pijshëm		2	
P.25 Ndriçimi rrugor		2	
P.26 Shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor	1		
P.27 Sport dhe reklamë		2	
P.28 Trashëgimia kulturore, ngjarjet artistike dhe kulturore		2	
P.29 Arsimi fillor dhe parashkollor	1		
P.30 Arsimit i përgjithshëm (parauniversitar)		2	
P.31 Arsimi profesional			0
P.32 Kujdesi shoqëror për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	1		
P.33 Kujdesi social për të moshuarit		2	
P.34 Kujdesi shoqëror për familjet dhe fëmijët	1		
P.35 Papunësia, arsimi dhe trajnimi	1		
P.36 Strehimi social	1		
Fondi rezervë			

*Burimi: Raporti i përputhshmërisë së monitorimit të performancës në nivel bashkie, MFE Tetor 2019, fq.11*

Për zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët mund të ndiqen qasje të ndryshme si:

1. Objektivat e planeve vendore për integrimin e këtyre pakicave dhe aktivitetet e parashikuara të reflektohen në programet buxhetore respektive, si dhe të identifikohen dhe planifikohen fondet në buxhet për t'i arritur këto objektiva.
2. Shqyrtimi sistematik i të gjitha programeve buxhetore me objektiv bërjen e ndryshimeve të nevojshme dhe evidentimin e projekteve, përmes të cilave mund të arrihen rezultate më të mira për fuqizimin dhe integrimin e romëve.
3. Shqyrtimi i treguesve të rezultateve dhe treguesve të synuar në vite për të identifikuar tregues me anë të të cilave mund të vlerësojmë ndikimin e programeve të ndryshme buxhetore në integrimin e pakicave romë dhe egjiptiane.



Në rastin e parë, vëmendja përqendrohet kryesisht tek identifikimi i objektivave të rinj buxhetor; ndërsa në rastin e dytë dhe të tretë, fokusi është tek aktivitetet dhe masat ekzistuese buxhetore për të parë se çfarë mund të përmirësohet për të mundësuar një buxhet të përgjigjshëm për romët duke përshtatur strukturën ose realizimin e aktiviteteve.

Të gjitha NJVQV-të që kanë miratuar “Planet Vendore për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve” dhe “Planet Sociale Vendore”, duhet të ndjekin qasjen e parë, pra të përshijnë në programet buxhetore respektive objektiva, aktivitete dhe projekte të planifikuara në këto plane. Ndërsa bashkitë e tjera mund të përdorin dy qasjet e tjera për t’i bërë buxhetet e tyre të përgjigjshme për pakicat.

Më poshtë paraqiten disa shembuj në lidhje me qasjet e mësipërme, të cilat sugjerojnë se si mund të ndërhyhet në programet buxhetore për t’i bërë ato të ndjeshme për pakicat. Ndërhyrjet propozohen në riformulimin e objektivave, treguesve dhe përcaktimin e synimeve në nivel programi buxhetor.

Tre shembujt e parë përfshihen në “kategorinë 1” të programeve buxhetore. Në shembullin 1, njëسيا e vetëqeverisjes vendore ka miratuar “Planin e zhvillimit të komunitetit rom dhe egjiptian”<sup>40</sup>, Objektivi, masat, treguesit dhe synimet janë përfshirë në dokumentin e PBA-së 2019-2021. Ndërsa treguesi i përcaktuar “*Nr. i familjeve që marrin shërbime pranë Qendrës Komunitare*” është një tregues i përgjithshëm. Në këtë shembull bashkia duhet të përfshijë një tregues shtesë të ndjeshëm për pakicat si: “*Nr. i familjeve rome dhe egjiptiane që marrin shërbim pranë QK ndaj nr.total të familjeve që marrin shërbim*”, i cili mund të paraqitet tek synimet në trajtën e përqindjes.

Objektivi i programit buxhetor në shembullin 2 nuk ka ndjeshmëri për pakicat, por masa e përcaktuar për arritjen e objektivit ka ndjeshmëri për pakicën rome. Bashkia ka parashikuar ndërhyrje në infrastrukturën e arsimit parashkollor në një objekt, që frekuentohet nga fëmijët e pakicës rome. Në këtë rast është ndjekur qasja e dytë, pra është evidentuar një projekt. NJVQV-të duhet të tregojnë kujdes në hartimin e treguesve të rezultateve dhe përcaktimin e synimeve, të cilat duhet gjithashtu të paraqesin ndjeshmëri për pakicën rome.

Shembulli 3 paraqet gjithashtu një situatë ku objektivi dhe masa nuk kanë ndjeshmëri për pakicat, por vëmendja përqendrohet tek treguesit e rezultateve dhe synimet në vite për të identifikuar tregues me anë të të cilave mund të vlerësojmë ndikimin e programeve të ndryshme buxhetore në integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane.

Dy shembujt e tjerë janë marrë nga programe buxhetore të “kategorisë 2”. Në shembullin 4 është evidentuar një projekt dhe janë rishikuar treguesit dhe synimet. Ndërsa në shembullin 5 janë përmirësuar treguesit e rezultateve dhe synimet në vite.

40 Bashkia Shkodër, Plani i zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptianë, 2017-2020



Shembulli 1: Programi “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, Bashkia Shkodër 2019-2021

Objektivi	Masa	Treguesit e rezultatit	Synimet			
			2018	2019	2020	
Krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi për shkak të aftësisë ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, etnisë	Vënia në funksion të plotë e qendrës komunitare për romët dhe egjiptianët dhe vazhdimi i aktiviteteve të planifikuara	Nr. i familjeve rome dhe egjiptiane që marrin shërbime pranë Qendrës Komunitare Nr. i familjeve rome dhe egjiptiane që marrin shërbime pranë QK ndaj nr. total të familjeve që marrin shërbim	Parashikohen rreth 100 familje përfituese të shërbimeve që do të ofrohen pranë qendrës 50% familje rome dhe egjiptiane që marrin shërbim	Parashikohen rreth 110 familje përfituese të shërbimeve që do të ofrohen pranë qendrës 55% familje rome edhe egjiptiane që marrin shërbim	Parashikohen rreth 120 familje përfituese të shërbimeve që do të ofrohen pranë qendrës 60% familje rome dhe egjiptiane që marrin shërbim	2021 Parashikohen rreth 120 familje përfituese të shërbimeve që do të ofrohen pranë qendrës 65% familje rome dhe egjiptiane që marrin shërbim

Burimi: Bashkia Shkodër, PBA 2019-2021, fq. 616

Shembulli 2: Programi “Arsimi Parauniversitar», Bashkia Fier 2019-2021

Objektivi	Masa	Treguesit e rezultatit	Synimet			
			2018	2019	2020	
Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në sistemin parauniversitar	Rikonstruktion Kopshti Rom Levan	Nr. i fëmijëve që do të frekuentojnë mjediset e reja; Nr. i fëmijëve romë dhe egjiptianë që përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës; Nr. i fëmijëve për grup	-Në vitin 2018 kopshti frekuentohet vetëm nga 20 fëmijë, nga 2 cilët asnjë nuk ishte nga pakica rome. Parashikohen rreth 40 fëmijë që do të frekuentojnë mjediset e kopshtit 50% e fëmijëve romë dhe egjiptianë 12-15 fëmijë për grup	Parashikohen rreth 50 fëmijë që do të frekuentojnë mjediset e kopshtit 55% e fëmijëve romë dhe egjiptianë 16-18 fëmijë për grup	Parashikohen rreth 60 fëmijë që do të frekuentojnë mjediset e kopshtit 60% e fëmijëve romë dhe egjiptianë 18-20 fëmijë për grup	2021 Parashikohen rreth 60 fëmijë që do të frekuentojnë mjediset e kopshtit 60% e fëmijëve romë dhe egjiptianë 18-20 fëmijë për grup



Shembulli 3: Programi “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, Bashkia Vlorë, PBA 2020-2022<sup>41</sup>

Objektivi	Masa	Treguesit e rezultatit	Synimet			
			2018	2019	2020	2021
Përmirësimi i infrastrukturës për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për qëndrimin dhe ushqimin e fëmijëve në çerdhe.	Mirëfunksionimi me kapacitet të plotë i çerdheve në territorin e bashkisë	Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë që përfitojnë shërbim në çerdhet e qytetit Nr.i fëmijëve romë dhe egjiptianë që përfitojnë shërbimin ndaj numrit total të fëmijëve	60 fëmijë përfitojnë nga shërbimi	60 fëmijë përfitojnë nga shërbimi	60 fëmijë përfitojnë nga shërbimi	60 fëmijë përfitojnë nga shërbimi
			5 % fëmijë romë dhe egjiptianë të moshës 0-3 vjeç përfitojnë shërbim	5 % fëmijëve romë dhe egjiptianë të moshës 0-3 vjeç përfitojnë shërbim	7 % fëmijëve romë dhe egjiptianë të moshës 0-3 vjeç përfitojnë shërbim	10 % fëmijëve romë dhe egjiptianë të moshës 0-3 vjeç përfitojnë shërbim

Shembulli 4: Programi “Trashëgimia kulturore dhe aktivitetet artistike”, Bashkia Korçë, 2019-2021

Objektivi	Masa	Treguesit e rezultatit	Synimet			
			2018	2019	2020	2021
Rritja e numrit të aktiviteteve kulturore të organizuar nga qendra e Artit dhe Kulturës	Organizim i javës kulturore të romëve dhe egjiptianëve (tradita, kultura, prodhimet artizanë, gjuha, muzika, etj.	Numri i aktiviteteve të realizuara Numri i romëve dhe egjiptianëve që përfitojnë nga aktivitetet Numri përgjithshëm i personave që marrin pjesë në aktivite	300 persona marrin pjesë në aktivitete;	350 persona marrin pjesë në aktivitete;	400 persona marrin pjesë në aktivitete’	450 persona marrin pjesë në aktivitete’
			80% romë dhe egjiptianë përfitojnë nga aktivitetet	77% romë dhe egjiptianë përfitojnë nga aktivitetet	75% romë dhe egjiptianë përfitojnë nga aktivitetet	70% romë dhe egjiptianë përfitojnë nga aktivitetet

41 Treguesit dhe synimet janë përshtatur për të këtë udhëzues



Shembulli 5: "Programi "Ndrëçimi i rrugëve", Bashkia Cërrik, 2019-2021

Objektivi	Masa	Treguesit e rezultatit	Synimet			
			2018	2019	2020	2021
Hapësirat publike janë të ndriçuara për të garantuar siguri në komunitet	Instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike;	Të përfaqe e hapësirave publike e mbuluar me ndriçim; Mbulimi me ndriçim i rrugëve në lagjen ku banojnë pakicat rome dhe egjiptiane	60% e hapësirave publike e ndriçuar	65% e hapësirave publike e ndriçuar	65% e hapësirave publike e ndriçuar	70% e hapësirave publike e ndriçuar
			5% e hapësirave ku banon pakica rome e ndriçuar	30% e hapësirave ku banon pakica rome e ndriçuar	50% e hapësirave ku banon pakica rome e ndriçuar	



### IV.3 Përcaktimi i produkteve, rezultateve, treguesve dhe shpenzimeve me perspektivën rome dhe egjiptiane

Gjatë përcaktimit të objektivave duhet të mbajmë parasysh që ato duhet të pasqyrojnë qartë se çfarë planifikohet të arrihet deri në fund të vitit dhe në periudhën afatmesme. Ato duhet të jenë gjithashtu të matshëm dhe të mundshëm për tu vlerësuar. Objektivat specifike në fushat që përfshihen në planet vendore (p.sh arsim, strehim, shëndetësi, punësim, etj.) duhet të reflektohen si objektiva në programin buxhetor afatmesëm. Ndërsa për programet e tjera buxhetore (si shërbimet publike, furnizimi me ujë, ndriçimi, etj) mund të formulohen mbështetur në analizën e nevojave realizuar për programet respektive.

Çdo objektiv mund të ketë një ose më shumë produkte. Produkti mund të konsiderohet si një produkt i realizuar ose shkaktuar nga një fond buxhetor. Produktet janë mallrat dhe shërbimet që duhen prodhuar për të kontribuar në arritjen e objektivave afatmesme dhe qëllimeve afatgjata.

Për secilin nga objektivat në programe të ndryshme buxhetore (p.sh arsimi parauniversitar, strehimi, transporti, kujdesi social për familjet dhe fëmijët, etj.) duhet të përcaktohen një ose më shumë produkte dhe/ose aktivitete që synojnë pakicat rome dhe egjiptiane dhe që duhen realizuar për të kontribuar në arritjen e objektivave afatmesme dhe afatgjata.

Shpenzimet në lidhje me aktivitete të ndryshme mund të përcaktohen sipas metodave të mëposhtme.

1. Për të gjitha aktivitetet që janë të përfshira në planet e veprimit duhet të mbahet në konsideratë kostoja e llogaritur dhe e miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak. Natyrisht që kjo shumë mund të ndryshojë nëse Bashkia ndryshon synimet për vitin buxhetor.
2. Për aktivitet e tjera mbahet parasysh shpenzimi i vitit paraardhës, i cili mund të korigjohet duke mbajtur parasysh synimet e përcaktuara në planin e veprimit.
3. Për projektet duhet të vendoset kostoja e plotë e projektit.

Objektivat e hollësishme, synimet, aktivitetet dhe treguesit që lidhen me integrimin në Planin e Bashkisë Korçë 2019-2022 për disa aktivitete janë paraqitur në tabelën 2



Tabela 2:<sup>42</sup> Plani i Bashkisë Korçë 2019-2022

Objektivi specifik	Aktiviteti	Produkti	Synimi	Treguesit	Buxheti
<b>Fusha 1: Arsimi/Objektivi strategjik: Përmirësimi i situatës arsimore të pakicave rome dhe egjiptiane</b>					
1.1 Lehtësimi i aksesit ndaj shërbimeve arsimore	1.1.1 Mbështetje financiare fëmijëve nga pakicat rome dhe egjiptiane që jetojnë në familje me vështirësi ekonomike	Fëmijët e grupmoshës 6-15 vjeç që ndjekin arsimin bazë.	- 95% e fëmijëve të regjistruar në arsimin bazë - 75% e fëmijëve romë dhe egjiptianë të regjistruar në arsimin bazë Braktisja nga romët dhe egjiptianët ulet me 5%	- Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të grupmoshës 6-15 vjeç - % e fëmijëve romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin bazë	1,200,000
<b>Fusha 2: Punësimi dhe fuqizimi ekonomik/ Objektivi strategjik: Fuqizimi ekonomik i pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë, përmes integritimit dhe harmonizimit të ndërrhyjeve për kualifikime, punësim dhe programeve të mbrojtjes sociale</b>					
2.2 Rritja e punësimit të pakicave rome dhe egjiptiane përmes mekanizmave nxitës për punëdhënësit dhe formalizimit të aktiviteteve prodhuese	2.2.4 Mbështetja e ngritjes së një inkubatori biznesi në zonën e Pazarit të vjetër :	Punëkërkuës romë dhe egjiptianë të punësuar përmes skemave nxitëse	Synohet që 15% e të punësuarve rishitazi do t'i përkasin pakicave rome dhe egjiptiane 80% e biznesesve punësojnë persona që i'u përkasin grupeve të rrezikuara	Numri i përfutuesve Të ardhurat e gjeneruara nga këto biznese	24,400,000

42. Produktet, synimi dhe treguesit janë ripunuar për qëllime të këtij udhëzuesi

**Fusha 3: Strehimi/ Objektiv strategjik: Përmirësimi i gjendjes së strehimit të pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë, përmes ndërhyrjeve të qëndrueshme**

3.1 Përmirësimi i kushteve në banesat ekzistuese të pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë	3.1.3 Rehabilitimi dhe sistemimi i kanalizimeve në zonat me popullsi rome dhe egjiptiane (prioritare Ish-geologjikja, Ndërtimi, Bujqësorja)	Familje që përfitojnë bonus qiraje Investimeve për rikonstruksionin e banesave dhe infrastrukturës për komunitete të varfëra	70% e familjeve R&E që kanë aplikuar për skemat e strehimit social kanë përmirësuar kushtet e banimit	Numri i projekteve të zbatuara Numri i familjeve rome dhe egjiptiane përfituese nga bonusi i qirasë Numri i përfituesve nga investimet % e romëve dhe egjiptianëve që përfitojnë nga investimet	1,900,000
--	---	--	---	--	-----------

**Fusha 4: Shëndeti/ Objektiv strategjik: Përmirësimi i shëndetit dhe aksesit në shërbimet shëndetësore për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë**

4.1 Rritja e ndërgjegjësimit dhe aksesit ndaj shërbimeve shëndetësore për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane	4.1.2 Mundësimi i vaksinimit të gjithë fëmijëve (edhe atyre të paregjistruar)	Fëmijët e grupmoshës 0-18 të vaksinuar.	Fëmijët e grupmoshës 0-18 vjeç të gjithë të vaksinuar.	Numri i rasteve të identifikuara Numri i rasteve të adresuara	800,000
---	---	---	--	--	---------



Në periudhën e hartimit të projekt buxhetit anëtarët e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve duhet të konsultojnë planet e veprimit për të evidentuar se cilat qëllime, objektiva specifike, aktivitete dhe projekte do të përfshihen në buxhetin afatmesëm.

Treguesit janë gjithashtu të nevojshëm për të matur nëse objektivat e formuluar janë arritur. Treguesit mund të jenë tregues faktorësh, tregues produkti dhe tregues të rezultateve.

- **treguesit e faktorëve:** numri familjeve romë dhe egjiptiane që kanë përfituar bonus strehimi, numri i familjeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike, numri i personave të stafit të trajnuar për ofrimin e shërbimeve për grupet në nevojë;
- **treguesit e produktit:** Numri i stafit të trajnuar në raport me numrin e përgjithshëm të stafit që ka nevojë për trajnim; numri i familjeve romë dhe egjiptiane që kanë marrë bonus strehimi në raport me numrin e përgjithshëm të familjeve që kanë përfituar bonus strehimi; numri i familjeve romë dhe egjiptiane që kanë marrë bonus strehimi në raport me numrin e përgjithshëm të familjeve romë dhe egjiptiane që kanë aplikuar për të përfituar bonus strehimi;
- **treguesit e rezultateve:** përqindja e romëve dhe egjiptianëve që gjetën një vend pune nga numri i përgjithshëm i atyre që kanë bërë një kurs të formimit profesional; përqindja e familjeve romë që kanë një strehim të qëndrueshëm nga zbatimi i programeve të strehimit social.

Nëpunësit e bashkisë sipas departamenteve do të duhet të identifikojnë dhe llogarisin **treguesit** që do të ndihmojnë për të monitoruar dhe vlerësuar shkallën në të cilën janë arritur rezultatet e programit ose projektit, si dhe sa janë arritur rezultatet e synuara.

Në tabelën 3 janë sjellë disa shembuj nga programet buxhetore. Në këto shembuj vihet në dukje me lehtësi lidhja midis qëllimit, objektivit specifik dhe aktivitetit. Rëndësi në fazën e planifikimit të buxhetit merr përcaktimi i synimeve mbi bazën e treguesve (të faktorëve, produkteve, rezultateve) që janë përcaktuar në planin e veprimit. Në momentin që është identifikuar aktiviteti/projekti që do të financohet duhet që të plotësohen dhe synimet. Synimet mund të jenë të matshme, duke pasqyruar specifikën e sfidave për programe të ndryshme.



**Tabela 3: Shembuj nga programet buxhetore**

**Programi buxhetor: Strehimi social<sup>43</sup>**

Qëllimi	Objektivi	Projekti	Treguesit e rezultatit	Synimet <sup>43</sup>		
				2019	2020	2021
Përmirësimi i gjendjes së strehimit të pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë përmes ndërhyrjeve të qëndrueshme	Përmirësimi i kushteve në banesat ekzistuese të pakicave rome dhe egjiptiane	Asfaltim/gjelbërim/ndricim i rrugëve të brendshme në lagjet me përqëndrim të pakicave rome dhe egjiptiane	Numri i projekteve të zbatuara; Numri i familjeve përfutuese; % e familjeve rome që përfutojnë; Numri i përfutuesve % e pakicës rome që përfutojnë ndaj totalit të përfutuesve	Do të financohet një projekt përfutojnë x familje rome dhe egjiptiane X % e pakicave rome dhe egjiptiane i kushtet e banimit	Do të financohet një projekt përfutojnë x familje rome dhe egjiptiane X % e pakicave rome dhe egjiptiane i kushtet e banimit	Do të financohet një projekt përfutojnë x familje R&E X % e pakicave rome dhe egjiptiane i kushtet e banimit

Burimi: Plani vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane, Bashkia Korçë 2019-2022

43 Synimet mungojnë në PV dhe duhet të rishikohen nga Bashkia për çdo vit buxhetor



### Programi buxhetor: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Qëllimi	Objektivi	Projekti	Treguesit e rezultatit	Synimet		
				2019	2020	2021
Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, nxitja e punësimit	Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë	Përcaktimi i kuota-ve për në kopshte dhe çerdhe për fëmijët në nevojë për mbrojtje (fëmijë në situatë rrugë në veçanti, romë/egjiptianë),	VKB për përcaktimin e kuotave Numri i fëmijëve që përfitojnë nga kuotat në raport me numrin e fëmijëve në nevojë për këtë shërbim	1 VKB për përcaktimin e kuotave Të paktën 5 fëmijë X % e fëmijëve në nevojë që përfitojnë shërbim	1 VKB për përcaktimin e kuotave Të paktën 5 fëmijë X % e fëmijëve në nevojë që përfitojnë shërbim	1 VKB për përcaktimin e kuotave Të paktën 5 fëmijë X % e fëmijëve në nevojë që përfitojnë shërbim

Burimi: Plani Social, Bashkia Roskovec 2019-2022



### Programi buxhetor: Transporti publik<sup>44</sup>

Qëllimi	Objektivi	Projekti	Treguesit e rezultatit	Synimet		
				2018	2019	2020
Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor në shërbim të qytetarëve	Sigurimi i aksesit të plotë në transportin publik të nxënësve, studentëve dhe kategorive të veçanta që përfitojnë sipas dispozitave ligjore	Subvencionimi i shpenzimeve të transportit urban për të gjitha kategoritë që përfitojnë sipas dispozitave ligjore	Nr. i kategorive të mbështetura me shpenzimet e transportit % e romëve dhe egjiptianëve ndaj totalit të përfituesve	70 % e kategorive në nevojë të mbështetura; 20% e totalit të mbështetur romë dhe egjiptianë	75 % e kategorive në nevojë të mbështetura; 23% e totalit të mbështetur romë dhe egjiptianë	80 % e kategorive në nevojë të mbështetura; 27% e totalit të mbështetur romë dhe egjiptianë
						85 % e kategorive në nevojë të mbështetura; 30% e totalit të mbështetur romë dhe egjiptianë

Burimi: PBA 2019-2021, Bashkia Shkoder, fq. 217<sup>45</sup>

### Programi buxhetor: Arsimi bazë përfshirë parashkollorin

Qëllimi	Objektivi	Projekti	Treguesit e rezultatit	Synimet		
				2018	2019	2020
Ofrimi i arsimit bazë dhe atij parashkollor për të rritur përqindjen e popullatës që dinë shkrim dhe këndim	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përmirësimi i cilësisë së akomodimit dhe edukimit në kopshtet publike;</li> <li>Rritja e kapacitetit akomodues në institucionet e ciklit parashkollor (kopsht publik);</li> </ul>	Rikonstruktion i pjesës së mirëmbajtjeve të zakonshme e objekteve të arsimit parashkollor	Nr. objekteve të rikonstruara  Përqindja e fëmijëve romë dhe egjiptianë që ndjekin institucionet e arsimit parashkollor kundrejt totalit të fëmijëve.	40 fëmijë, 5% fëmijë të pakicës rome	1 kopësht, 60 fëmijë, 10% fëmijë të pakicës rome	60 fëmijë, 15% fëmijë të pakicës rome
						60 fëmijë, 20% fëmijë të pakicës rome

Burimi: Draft Plani i Performancës 2020-2022, Bashkia Belsh

44 Nëse numri i fëmijëve në nevojë për këtë shërbim është 20, atëherë synimi do të jetë 20% e fëmijëve në nevojë përfitojnë këtë shërbim

45 Synimet të ndryshuara



## IV.4 Garantimi i përfshirjes së nevojave të pakicave rome dhe egjiptiane në buxhet

Administrata vendore dhe Këshilli Bashkiak duhet të identifikojnë prioritetet e lidhura me pakicat rome dhe egjiptiane që janë në përputhje me politikat e tyre vendore dhe ato sektoriale dhe të hartojnë buxhete që adresojnë këto përparësi. Prioritetet nevojiten të reflektohen në përcaktimin e taveve buxhetore të sektorëve gjatë procesit të hartimit të PBA-së dhe buxhetit vjetor. NJVQV-të mund ta arrijnë këtë përmes:

- rishikimit të prioriteteve dhe rishpërndarjes së burimeve;
- zbatimit të parimeve të buxhetimit të përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët;
- llogaritjes së kostove duke marrë në konsideratë dallimet midis këtyre pakicave dhe grupeve të tjera që përfitojnë shërbime.

NJVQV-të duhet të marrin në konsideratë krijimin e buxheteve të përgjigjshme për romët dhe egjiptianët duke zbatuar disa nga praktikatat më të mira si:

Bashkitë mund të fuqizojnë përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve në procesin e **buxhetimit me pjesëmarrje**. Decentralizimi dhe reforma administrative kanë krijuar hapësira për më shumë pjesëmarrje të pakicave, për të marrë në konsideratë më mirë nevojat dhe përparësitë më të ngutshme të qytetarëve në fusha të ndryshme. Sipas ligjit për financat vendore bashkitë duhet të konsultojnë me komunitetin dhe grupet e interesit programet buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore<sup>46</sup>. Përfshirja mund të realizohet përmes organizimit të konsultimeve/takimeve me anëtarë dhe drejtues të pakicave rome dhe egjiptiane. Takimet thirren dhe organizohen nga stafi i bashkisë dhe në to duhet të diskutohet kryesisht për investimet kapitale dhe politikat sociale që kanë ndikim të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë mbi integrimin e pakicave.

Në njësitë administrative ku ka përqendrim të mëdha të pakicave rome dhe egjiptiane si në bashkitë Elbasan, Fier, Korçë duhet të organizohen takime të veçanta me pjesëmarrjen e komunitetit, duke bërë kujdes që të mbahet në konsideratë përfaqësimi sipas gjinisë dhe grup moshave. Në këto takime duhet të ftohen dhe organizatat e shoqërisë civile. Stafi i bashkisë duhet të bëjë kujdes që njoftimi të publikohet në kohë dhe të përcillet tek komuniteti përmes formave të ndryshme si: njoftime në median vendore, postera në afërsi të lagjeve të banuara nga pakicat, njoftimeve derë më derë, etj. Ndërsa në njësitë administrative me numër të vogël të pakicave duhet të bëhet kujdes që në takimet me komunitetin të përfaqësohen dhe pakicat rome dhe egjiptiane. Në këto njësi një rol të madh mund të luajnë

46 Neni 5, Ligji nr. 68, datë 27.4.2017 "Për financat e qeverisjes vendore"



organizatat e shoqërisë civile për identifikimin dhe përzgjedhjen e përfaqësuesve të pakicave, që do të marrin pjesë në takim.

Autoritetet vendore duhet të këshillohen me pakicat rome dhe egjiptiane që në fazën e parë të hartimit të projekt buxhetit afatmesëm (periudha mars-qershor), për të garantuar që barazia, fuqizimi dhe integrimi i tyre do të merret parasysh dhe do të pasqyrohen në buxhetin e miratuar në fund të vitit.

Takimet mbi buxhetin duhet të lehtësohen nga ekspertë dhe duhet të jenë ndërvepruese. Pas prezantimit të përmbledhur të buxhetit, takimi duhet të vazhdojë me një sesion pyetje-përgjigjeje, ku pjesëmarrësit në mbledhje mund të marrin përgjigje nga autoritetet e qeverisë vendore dhe të bëjnë komente, sugjerime dhe propozime.

Bashkitë mund dhe duhet të analizojnë politikat dhe programet buxhetore ekzistuese nga perspektiva e pakicave. Boshllëqet e identifikuara duhet të adresohen, duke identifikuar mënyrat dhe mjetet se si ato mund të zvogëlojnë pabarazitë ekzistuese. NJVQV-të duhet të ndërmarrin veprime, mbështetur në vlerësimin e integritetit të pakicave rome dhe egjiptiane, që synojnë të krijojnë një strategji të buxhetimit të përgjigjshëm për romët.

**Realizimi i ndërhyrjeve në hapa të ndryshme të ciklit të buxhetit.** NJVQV-të duhet të bëjnë vlerësime të synuara për pakicat rome dhe egjiptiane në hapa të ndryshëm të ciklit të buxhetit si:

- *kur bëhet programimi i qëllimeve dhe objektivave.* Objektivat specifike të programeve buxhetore duhen rishikuar. Objektivat specifike të miratuara në planet e integritetit, mund të bëhen pjesë e objektivave të programeve buxhetore (p.sh arsimit parauniversitar, strehimi, kujdesi social, etj). Ndërsa në programet e tjera mund të riformulohen objektivat specifike për të adresuar nevojat e pakicave (p.sh transporti, menaxhimi i mbetjeve, etj.).
- *gjatë miratimit të tavaneve buxhetore.* Në këtë fazë mund të parashikohen më shumë fonde për politikat ekzistuese dhe politikat e reja që synojnë pakicat rome dhe egjiptiane.
- *përcaktimi i masave/aktiviteteve për arrijen e objektivave.* Në buxhetet duhet të identifikohen projekte dhe masa që synojnë këto komunitete, mundësisht me të njëjtin emërtim që janë vendosur në planet e integritetit.
- *monitorimi i treguesve të rezultateve.* Në këtë fazë duhet të identifikohen tregues të ndryshëm për pakicat dhe jo vetëm statistika të thjeshta.



## IV.5 Hartimi i deklaratës për buxhetimin e përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët

Bashkitë mund të hartojnë një Deklaratë për buxhetin e përgjigjshëm për pakicat që është pjesë e materialit të buxhetit që paraqitet në Këshillin Bashkiak për miratim.

Deklarata mund të jetë në formën e një tabele, ose një raport i shkurtër, ku NJVQV-të paraqesin politikat, programet dhe buxhetet respektive, që lidhen me fuqizimin dhe integrimin e romëve dhe egjiptianëve. Deklarata duhet të përshkruajë në përgjithësi se si programet dhe buxhetet e NJVQV-ve kontribuojnë në integrimin e këtyre pakicave dhe mund të konsiderohet dhe si një raport përgjegjshmërie për NJVQV-të në lidhje me objektivat e përcaktuara për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane.

*Kur duhet të jetë gati buxheti i përmbledhur nga NJVQV-të?* NJVQV-të duhet të përgatisin dhe të shpërndajnë buxhetin e përmbledhur përpara se të miratojnë draft buxhetin për vitin e ardhshëm. Buxheti i përmbledhur iu mundëson pakicave informacionin e nevojshëm për të marrë pjesë në seancat dëgjimore për buxhetin dhe për të diskutuar për mënyrën se si buxheti vendor adreson nevojat e tyre. Ky dokument duhet të shpërndahet të paktën një javë përpara seancave dëgjimore.

Është shumë e rëndësishme të kemi parasysh që informacioni mbi buxhetin shpesh herë është i vështirë për t'u kuptuar, kjo në mënyrë të veçantë për pakicat rome dhe egjiptiane të cilët nuk janë mësuar me terminologjinë e procesit të buxhetit. Buxheti i përmbledhur nuk ka si qëllim diskutimin gjithëpërfshirës të buxhetit të pushtetit vendor, por theksimin e informacionit më të rëndësishëm në një mënyrë sa më të kuptueshme për qytetarët.

*Si mund të zbatohet?* Deklarata për buxhetin e përgjigjshëm rom dhe egjiptian duhet të përfshihet në relacionin e buxhetit. Në të duhet të përfshihet informacion mbi nevojat e identifikuar për pakicat rome dhe egjiptiane gjatë planifikimit të buxhetit<sup>47</sup>, cilat janë programet buxhetore/aktivitetet ku janë adresuar nevojat, sa fonde janë parashikuar në buxhet dhe për cilën periudhë.

**Shembull:** Bashkia ka zbuluar që shkalla e pjesëmarrjes së fëmijëve rom në arsimin parashkollor është e ulët dhe pas analizës së shkaqeve, rezultoi që kopshti në afërsi të vendbanimit ka kapacitetet të ulët. Bashkia ka vendosur që të rikonstruktojë kopshtin ekzistues dhe të rrisë me 30% kapacitetin e tij.

47 Plani vendor për integrimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptianë, Plani Social, etj.



**Shembull:** Bashkia ka identifikuar që 10 familje të pakicës rome jetojnë në kushte të papërshtatshme strehimi. Në banesat e tyre mungon aksesimi në ujë dhe ujë të pijshëm, nuk ka kanalizime dhe barakat janë ndërtuar me mjete rrethore. Trualli ku banojnë këto familje është në pronësi të bashkisë. Bashkia ka hartuar projektin për rikonstruksionin e këtyre banesave, i cili do të paraqitet në MFE për vitin 2021. Në projektbuxhet është parashikuar kontributi i bashkisë në masën 20% të vlerës së përgjithshme të projektit.

Më poshtë jepet një format i thjeshtë i përgjithshëm për deklaratën, për të cilën duhet të japin informacion të gjitha drejtoritë në bashki. Përveç informacionit që lidhet me objektivat dhe masat, secili departament duhet të sigurojë informacion për situatën e romëve dhe egjiptianëve në sektorin respektiv, numrin e përfituesve nga masat që do të zbatohen dhe treguesit e rezultateve.



**Tabela 4<sup>48</sup>: Deklarata për buxhetin e përgjigjshëm rom dhe egjiptian**

Programi	Objektivi specifik	Masa ose projekti i planifikuar	Treguesit e rezultateve	Përfituesit R&E	Buxheti
Strehimi social	Sigurimi i strehimit social për kategoritë në nevojë	Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin rom në NJA "X"	10% e familjeve romë përfitojnë strehim të qëndrueshëm Nr. i aplikimeve për programet e financuara nga qeveria për strehimin social	26 familje përfituese	1,900,000 (bashkëfinancim)
Kujdesi shoqëror për familjet dhe fëmijët	Mbulimi sa më i plotë i territorit, të Bashkisë, me shërbime sociale duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit.	Identifikimi dhe mbrojtja e fëmijëve në situatë rruge.	Numri i fëmijëve në situatë rruge të mbështetur % e fëmijëve romë dhe egjiptianë të mbështetur	100 fëmijë në situatë rruge	1,000,000
Arsimi bazë dhe parashkollor	Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin bazë dhe parashkollor	Trajtimi ushqimor për arsimin bazë dhe parashkollor	% e fëmijëve romë dhe egjiptianë që përfitojnë nga shërbimi; Rritet me 7% regjistrimi i fëmijëve romë në arsimin parashkollor	200 nxënës në arsimin bazë dhe 30 në arsimin parashkollor	4,200,000
Furnizimi me ujë	Furnizimi me ujë të pijshëm i qytetit dhe njësisë administrative të Bashkisë	Subvencionimi i tarifës së lidhjes së kontratës dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë.	Numri i familjeve në nevojë % e familjeve romë dhe egjiptiane që përfitojnë subvencion % e familjeve romë që kanë akses në ujë të pijshëm	500 familje	210,000

48 Tabela paraqet një model se si mund të hartohet një deklaratë e thjeshtë

Ky është një instrument i rëndësishëm që mund të përdoret për zbërthimin e shpenzimeve në kategori të caktuara/projekte të rëndësishme dhe për të shpjeguar efektin që ato kanë mbi këto pakica. Ndikimi i projekteve duhet të reflektohet tek synimet dhe treguesit e rezultateve.

Për informimin e pakicave mund gjithshtu të realizohet një **fletëpalosje** ose një **përmbledhje me të dhëna të shkurtra** që prezanton buxhetin e NJVQV-së. Buxheti i përmbledhur duhet të prezantohet të ardhurat dhe shpenzimet si dhe rezultatet konkrete nga përdorimi i fondeve publike të shprehura në produkte dhe shërbime të ofruara për pakicat. Buxheti i përmbledhur mund të jetë një publikim vjetor që i ofrohet pakicave rome dhe egjiptiane për t'i informuar rreth shpenzimeve të fondeve publike, por edhe për të inkurajuar përfshirjen e tyre në monitorimin e arritjeve dhe rezultateve.

Duke lexuar buxhetin e përmbledhur, pakicat rome dhe egjiptiane mund të informohen më shumë në lidhje me të ardhurat e buxhetit nga burimet vendore (taksa, tatime, të ardhura të tjera) dhe buxheti i shtetit, si dhe të kuptojnë kufizimet që NJVQV-të kanë në burimet e të ardhurave. Në anën tjetër, pakicat rome dhe egjiptiane mund të ndërjegjësohen për nevojat e komunitetit të tyre dhe të informohen se cilat janë shpenzimet e domosdoshme që duhen bërë dhe si ato lidhen me prioritetet për fuqizimin dhe integrimin e këtyre pakicave. Natyrisht që përdorimi i këtij instrumenti është sfidues për bashkitë, pasi duhet të përdoret një gjuhë e thjeshtë dhe e kuptueshme për pjesën më të madhe të pakicave.

Informacioni kryesor që mund të përfshihet është:

- burimet e të ardhurave (mundësisht në paraqitje grafike);
- shpenzimet sipas programeve (paraqitje grafike në %);
- lista e projekteve të investimeve të financuara (pjesërisht apo totalisht) nga buxheti i pushtetit vendor për pakicat rome dhe egjiptiane;
- informacion rreth adresimit të nevojave të lidhura me pakicat në programet që ofrojnë shërbime ose subvencione: (qendrat komunitare, NE, AK, punësimi, kopshtet, etj.)
- Informacion rreth seancës dëgjimore mbi draft buxhetin.

Pjesëmarrja e pakicave rome dhe egjiptiane konsiston në ndjekjen e seancave dëgjimore mbi draft buxhetin dhe në ngritjen e propozimeve dhe sugjerimeve për parashikimin e fondeve për objektiva dhe masa që fuqizojnë këto dy pakica.



## IV.6 Monitorimi i politikave dhe buxhetimit të përgjigjshëm rom dhe egjiptian

Procesi i monitorimit të zbatimit të buxhetit është thelbësor pasi nëpërmjet tij vlerësohet në mënyrë të drejtpërdrejtë jo vetëm zbatimi i buxhetit të përgjigjshëm për romët dhe egjiptianët, por dhe zbatimi i planit vendor për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane. Monitorimi mund realizohet nga *aktorë të brendshëm* dhe nga *aktorë të jashtëm*. Në të dyja rastet është e rëndësishme që raportet përkatëse t’iuh bëhen me dije qytetarëve dhe të publikohen në faqen e internetit të bashkisë.

Monitorimi është procesi i ndjekjes së realizimit të objektivave specifike. Në përgjithësi ekzistojnë qasje të ndryshme për monitorimin e buxheteve vendore, por në modelet që paraqiten më poshtë do të përqëndrohemi kryesisht në atë sesi burimet buxhetore përdoren për të promovuar barazinë midis pakicave dhe pjesës tjetër të popullsisë për të promovuar fuqizimin e pakicave rome dhe egjiptiane dhe realizimin e të drejtave të tyre.

Monitorimi i buxhetit është i lidhur ngushtësisht me monitorimin e politikave dhe aktiviteteve, sepse është e rëndësishme të merren parasysh se për çfarë dhe si përdoren në të vërtetë paratë. Monitorimi i aktiviteteve shpesh herë është sfidues, sepse bashkitë e perceptojnë këtë si një “kërcënim” ose sikur janë të kontrolluar.

Monitorimi mund të realizohet nga NJVQV-të (*aktorë të brendshëm*) dhe organizatat e shoqërisë civile (*aktorë të jashtëm*). NJVQV-të nevojiten të kuptojnë qëllimin përfundimtar të monitorimit i cili është në interes të administratës vendore. Ndërsa OJF-të duke monitoruar aktivitetet kontribuojnë për të siguruar përdorimin efiçent dhe efektiv të burimeve publike dhe për qeverisje të mirë.

Roli i NJVQV-ve mbi monitorimin dhe raportimin e zbatimit të buxhetit vendor është parashikuar nga ligji “Për financat vendore”<sup>49</sup>. Ligji ka parashikuar si më poshtë:

1. Nëpunësit autorizues të njëjësive të vetëqeverisjes vendore i paraqesin këshillit përkatës, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve të udhëzimit të Ministrisë të Financave për monitorimin e zbatimit të buxhetit.
2. Monitorimi i zbatimit të planeve strategjike të zhvillimit kryhet nëpërmjet monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor.
3. Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit publikohen nga nëpunësi autorizues në faqen zyrtare të njëjësive përkatëse, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit, dhe një kopje e tyre i dërgohet Ministrisë së Financave.

49 Neni 48, Ligji nr.68/2017 «Për financat vendore»





4. Për raportimet e ndërmjetme, kur nga ana e Ministrisë së Financave vërehet problematikë

NJVQV-të duhet të përfshijnë në raportet e monitorimit dhe të dhëna mbi zbatimin e buxhetit të përgjigjshëm për romët dhe Egjiptianët. Tabela 5 paraqet një model i thjeshtë për raportet katërmujore të monitorimit.

**Tabela 5: Raportimi i shpenzimeve për masat që synojnë pakicat rome dhe egjiptiane në buxhetin e 2019**

Objektivi Specifik	Masa/aktiviteti/projekti	Buxheti në lekë	Shpenzimet faktike	Realizimi në %
Sigurimi i strehimit social për kategoritë në nevojë	Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin rom në NJA "X"	1,900,000	0	0%
Mbulimi sa më i plotë i territorit të bashkisë, me shërbime sociale duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit.	Identifikimi dhe mbrojtja e fëmijëve në situatë rruge.	1,000,000	300,000	30.0%
Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin bazë dhe parashkollor	Trajtimi ushqimor për arsimin bazë dhe parashkollor	4,200,000	1,000,000	23.8%
Furnizimi me ujë të pijshëm i qytetit dhe njësisive administrative të bashkisë	Subvencionimi i tarifës së lidhjes së kontratës dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë.	210,000	120,000	57.1%

*Shënim: Raportimi lidhet me deklaratën për buxhetin e përgjigjshëm*

Ndërsa në relacionin e buxhetit faktik NJVQV-të duhet të raportojnë në detaje realizimin e shpenzimeve për secilin program buxhetor, si dhe arritjet e programit mbi bazën e treguesve të miratuar. Tabela 6 paraqet një format të raportimit të shpenzimeve duke mbajtur në konsideratë lidhjen e secilit program me përfshirjen e pakicave rome dhe egjiptiane.



**Tabela 6: Shpenzimet faktike për pakicat rome dhe egjiptiane sipas programeve buxhetore**

Programet Buxhetore	Lidhja	Shpenzimet 2019	Pesha në %	Shpenzime që synojnë R&E	Pesha në %
P.1 Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	0	272,039	9.9%	0	0.0%
P.2 Çështje financiare dhe fiskale	0	0	0.0%	0	0.0%
P.3 Gjendja civile	0	14,900	0.5%	0	0.0%
P.4 Pagesa e shërbimit të borxhit të brendshëm	0	0	0.0%	0	0.0%
P.5 Shërbimet e policisë vendore	0	21,201	0.8%	0	0.0%
P.6 Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi	0	46,771	1.7%	0	0.0%
P.7 Marrëdhëniet me komunitetin	1	0	0.0%	0	0.0%
P.8 Ndihma për zhvillimin ekonomik	2	8,924	0.3%	3,724	0.5%
P.9 Shërbimi, akreditimi, inspektimi i tregut	2	500	0.0%	100	0.0%
P.10 Shërbimet bujqësore, inspektimi dhe siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	0	2,424	0.1%	0	0.0%
P.11 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	0	44,364	1.6%	0	0.0%
P.12 Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	0	20,076	0.7%	0	0.0%



P.13 Sistemi rrugor (rural + urban)	2	168,529	6.1%	38,000	5.2%
P.14 Transporti publik	2	13,494	0.5%	4,000	0.5%
P.15 Projektet e zhvillimit	2	0	0.0%	0	0.0%
P.16 Zhvillimi i turizmit	0	6,370	0.2%	0	0.0%
P.17 Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave	1	202,228	7.3%	50,000	6.8%
P.18 Menaxhimi i ujërave të zeza dhe i kanalizimeve	2	15,000	0.5%	5,000	0.7%
P.19 Programet për mbrojtjen e mjedisit	0	0	0.0%	0	0.0%
P.20 Ndërgjegjësimi mjedisor	0	0	0.0%	0	0.0%
P.21 Planifikimi urban vendor	2	2,146	0.1%	560	0.1%
P.22 Programet e zhvillimit	2		0.0%	0	0.0%
P.23 Shërbimet publike vendore	2	79,030	2.9%	10,000	1.4%
P.24 Furnizimi me ujë të pijshëm	2	53,761	2.0%	23,300	3.2%
P.25 Ndriçimi rrugor	2	95,832	3.5%	15,000	2.0%
P.26 Shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor	1	1,500	0.1%	200	0.0%



P.27 Sport dhe reklamë	2	116,283	4.2%	0	0.0%
P.28 Trashëgimia kulturore, ngjarjet artistike dhe kulturore	2	84,613	3.1%	8,000	1.1%
P.29 Arsimi fillor dhe parashkollor	1	263,450	9.6%	56,000	7.6%
P.30 Arsimit i përgjithshëm (parauniversitar)	2	46,565	1.7%		0.0%
P.31 Arsimi profesional	0	65,332	2.4%	0	0.0%
P.32 Kujdesi shoqëror për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	1	20,026	0.7%	5,000	0.7%
P.33 Kujdesi social për të moshuarit	2	0	0.0%	0	0.0%
P.34 Kujdesi shoqëror për familjet dhe fëmijët	1	1,065,736	38.7%	500,000	68.2%
P.35 Papunësia, arsimit dhe trajnimi	1	0	0.0%	0	0.0%
P.36 Strehimi social	1	16,062	0.6%	14,000	1.9%
Fondi rezerve		4,949	0.2%	0	0.0%
<b>Totali</b>		<b>2,752,105</b>	<b>100.0%</b>	<b>732,884</b>	<b>100%</b>

*Lidhja: Direkte (1); E tërthortë (2); I palidhur (0)*

Ndërsa se çfarë duhet të monitorojnë OJF-të me saktësi dhe qasjet që zgjedhin do të varet nga përparësitë e tyre dhe qëllimi specifik i monitorimit. Monitorimi mund të realizohet në nivele të ndryshme. Në tabelën 1 jepen shembuj pyetjesh, që mund të përdoren për monitorimin në të gjitha nivelet nga ana e OJF-ve.



**Tabela 7: Nivelet e ndryshme të monitorimit<sup>50</sup>**

Niveli	Monitorimi i aktiviteteve - Shembuj pyetjesh
<b>Vendim-marrja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kush është përfshirë në vendimmarrje në lidhje me politikat dhe buxhetet e parashikuara për pakicat?</li> <li>• Si dhe sa përfaqësohen pakicat romë dhe egjiptiane në vendimmarrje?</li> <li>• A kanë patur mundësi aktorët e interesuar nga shoqëria civile, veçanërisht ata që përfaqësojnë perspektivat e pakicave romë dhe egjiptiane, për pjesëmarrje thelbësore në procesin e buxhetimit?</li> </ul>
<b>Faktorët</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sa para janë akorduar për aktivitetet specifike që dëshironi të monitoroni?</li> <li>• Sa para janë akorduar në krahasim me vitin (a) e kaluar?</li> <li>• Sa para janë akorduar për aktivitete që synojnë pakicat, për çështje të fuqizimit të pakicave romë dhe egjiptiane, etj?</li> <li>• Si kanë ndryshuar fondet e akorduara krahasuar me vitin e kaluar?</li> <li>• Sa është përqindja e buxhetit për pakicat romë dhe egjiptiane krahasuar me buxhetin e përgjithshëm? A ka para të mjaftueshme për të realizuar aktivitetet?</li> <li>• A janë shpenzuar paratë e akorduara në buxhetin e këtij viti?</li> <li>• Sa staf është në dispozicion për të zbatuar politikat? A ka pjesëtarë nga pakicat romë dhe egjiptiane?</li> <li>• A ka strategji dhe plane veprimi për fuqizimin dhe integrimin e romëve dhe egjiptianëve dhe a janë të financuara mjaftueshëm?</li> </ul>
<b>Pro-duktet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilat janë shërbimet e ofruara, transfertat e paguara në kesh, etj? Cilat janë projektet e investimeve? A është cilësia e shërbimeve e përshtatshme për të përbushur nevojat e pakicave romë dhe egjiptiane?</li> <li>• Sa romë dhe egjiptianë, sa gra dhe burra përfitojnë nga shërbimet, investimet ose transferimet në para? Kush është në gjendje t'i përdorë dhe kush nuk është në gjendje t'i përdorë ato?</li> <li>• A adresojnë shërbimet, investimet, transferimet e parave në kesh, etj. mangësitë dhe pabarazitë më të rëndësishme të romëve dhe egjiptianëve?</li> </ul>
<b>Rezultatet dhe ndikimit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• A po kontribuojnë shërbimet, investimet, transferimet e parave në kesh për të përmirësuar nivelin e jetesës së këtyre pakicave? A e lënë ato të pandryshuar apo e rrisin varfërinë?</li> <li>• Si po ndryshon situata në lidhje me pabarazitë kryesore ekzistuese? Për shembull: A ka një përmirësim të kushteve të strehimit? A janë të rinjtë romë të arsimuar më mirë? A ka më shumë të rinj romë të punësuar dhe që sigurojnë të ardhura?</li> <li>• Si po kontribuojnë buxhetet (dhe politikat) për të siguruar të drejtat e pakicave?</li> <li>• A kontribuojnë buxhetet (dhe politikat) në zbatimin e varfërisë së pakicave romë dhe egjiptiane?</li> </ul>

Burimi<sup>51</sup>: Pyetjet janë përshtatur për buxhetimin e përgjigjshëm rom dhe egjiptian

50 Përshtatur sipas GRB, Manual for CSO, UN Women 2015

51 GRB, Manual for CSO, UN Women 2015



OJF-të mund të përballen me një numër sfidash kur planifikojnë monitorimin e buxhetit, për shembull burime të kufizuara, mungesë njohurish për të kryer një analizë të thellë, mungesë evidencash dhe të dhënash, veçanërisht mungesë të qasjes në informacione për buxhetin.

Nuk ka asnjë zgjidhje të lehtë për të kapërcyer këtë, por është e rëndësishme që OJF-të të mbajnë parasysh, që duke krijuar aleanca dhe partneritete me OJF të tjera dhe grupe të tjera të interesuara, mund të jenë në gjendje t'i tejkalojnë këto sfida.

Për studime, OJF-të mund të angazhojnë akademikë/ose kërkues që mund të bëjnë analiza më të thella. Në lidhje me mungesën e të dhënave dhe statistikave, në hulumtimin e tyre fillestar gjithmonë mund të dëgjoni se nuk ka statistika për romët dhe egjiptianët. Edhe nëse kjo mund të ndodhë në një masë të madhe, një vështrim nga afër mund të jetë i vlefshëm. Ndoshta departamenti që është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave mbi përdoruesit e shërbimeve mund të vendosë në dispozicion të dhënat fillestare.

Si fillim, ju mund të përdorni të dhënat që janë në dispozicion dhe rezultatet e monitorimit të parë mund të shërbejnë për të nënvizuar boshllëqet e të dhënave dhe nevojën për të mbledhur të dhëna shtesë. Në këtë rast, advokimi për të dhënat dhe statistikat, që duhet të mbledhen dhe sigurohen nga bashkia, mund të jetë një nga aktivitetet e mëtejshme, në kontekstin e advokimit rreth rezultateve të monitorimit.



## Aneks 1:

# Konventat, ligjet dhe aktet nënligjore

### Instrumentet në kuadrin e OKB-së

---

1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) e vitit 1948
2. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (nënshkruar në 1966, ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991)<sup>52</sup>
3. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (nënshkruar në 1966, ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Ratifikuar në vitin 1991)<sup>53</sup>.
4. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD)<sup>54</sup>(miratuar në 13 dhjetor 2006, ka hyrë në fuqi me 3 maj 2008 ratifikuar në vitin 2012.<sup>55</sup>
5. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)<sup>56</sup>, (miratuar në 18 Dhjetor 1979, ka hyrë në fuqi më 1981, ratifikuar në vitin 1993).<sup>57</sup>
6. Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, (e miratuar në vitin 1966, ka hyrë në fuqi në vitin 1969, ratifikuar në vitin 1993).<sup>58</sup>
7. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (CRC)<sup>59</sup>, e miratuar 1989, ka hyrë në fuqi në 1990, ratifikuar në vitin 1992)<sup>60</sup>

---

52 Ligj nr. 7510 date 08.08.1991

53 Ligj Nr. 7511 date 08.08.1991

54 Convention on the Rights of Persons with Disabilities

55 Ligji Nr. 108 datë 15.11.2012

56 Convention on the Elimination of all forms of Discrimination Against Women

57 Ligji 1769/ 9.11.1993

58 Ligji Nr. 7768, datë 09.11.1993

59 Convention on the Rights of the Child

60 Ligj datë 27.02.1992



## Instrumentet në kuadrin e Këshillit të Evropës

1. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore<sup>61</sup> është nënshkruar në Romë me 4 nëntor 1950 dhe hyri në fuqi më 3 shtator të vitit 1953. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në vitin 1996<sup>62</sup>
2. Protokollin 12 (2000) i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, (ratifikuar prej Shqipërisë në nëntor 2004 dhe hyrë në fuqi më 5 prill 2005).
3. Karta Sociale Evropiane e rishikuar<sup>63</sup>, (e nënshkruar më 1998 dhe e ratifikuar prej Shqipërisë në vitin 2002)
4. Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e ratifikuar prej Shqipërisë në vitin 1999.<sup>64</sup>
5. Konventa Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje<sup>65</sup> e ratifikuar prej Shqipërisë në vitin 2012

## Standardet e Bashkimit Evropian

1. Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta)

## Kuadri Ligjor Shqiptar

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Ligji nr. 10 221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"
3. Ligji Nr. 96/2017 "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë"
4. Ligji Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
5. Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"
6. Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"

61 KEDNj u nënshkrua në nëntor 1950 dhe hyri në fuqi në shtator 1953 pas ratifikimit të dhjetë të saj nga Dukati i Luksemburgut

62 Ligji Nr. 8137, datë 31.07.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", i ndryshuar.

63 Ligji Nr. 8960, datë 24.10.2002

64 Ligji Nr. 8496, datë 03.06.1999

65 Ligj Nr. 104 datë 11.08.2012 "Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje"





## Referencat

---

Council of Europe, Directorate General of Human Rights and Legal Affairs (2009), *Gender budgeting: practical implementation, Handbook*, <https://rm.coe.int/1680599885>

Eurocities (2017), *Mapping of the situation of Roma in cities in Europe* [http://nws.eurocities.eu/MediaShell/media/Mapping\\_of\\_the\\_situation\\_of\\_Roma\\_in\\_cities\\_FINAL\\_REPORT.pdf](http://nws.eurocities.eu/MediaShell/media/Mapping_of_the_situation_of_Roma_in_cities_FINAL_REPORT.pdf)

European Institute for Gender Equality (2019) *Gender statistics and indicators* <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-statistics-indicators>

Federal Chancellery – Federal Minister for Women and Civil Service, (2012): *Guidance Gender Budgeting in Public Administration*

Gajda, Robert (2018): *Raporti Vjetor Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi* <https://kmd.al/wp-content/uploads/2019/03/RAPORTI-VJETOR-2018.pdf>

GRB project Ukraine, *Gender Responsive Budgeting: Analysis of Budget Programmes from Gender Perspective* <https://library.fes.de/pdf-files/bueeros/ukraine/11556.pdf>

Regional Council, Roma Integration 2020 (2018) *Guidelines for Roma Responsive Budgeting* <https://www.rcc.int/romaintegration2020/docs/96/guidelines-for-roma-responsive-budgeting>

Ronnie Downes, Lisa von Trapp & Scherie Nicol (2017), *Gender responsive budgeting in OECD countries* <http://www.oecd.org/gender/Gender-Budgeting-in-OECD-countries.pdf>

MSHMS, Plani Kombëtar i Veprimit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve [http://shendetesia.gov.al/wpcontent/uploads/2018/06/Plani\\_kombetar\\_i\\_veprimit\\_per\\_integrimin\\_e\\_Romeve\\_dhe\\_Egjiptianeve\\_2016-2020.pdf](http://shendetesia.gov.al/wpcontent/uploads/2018/06/Plani_kombetar_i_veprimit_per_integrimin_e_Romeve_dhe_Egjiptianeve_2016-2020.pdf)

Programet buxhetore afatmesme të bashkive <http://financatvendore.al/buxhetet>

UN Human Rights Office and International Budget Partnership, (2017) *Realizing Human Rights through Government Budgets* <https://www.internationalbudget.org/publications/realizing-human-rights-government-budgets/>

UN Women (2015), *Gender Responsive Budgeting, Manual for Municipalities* [https://www.academia.edu/35979544/GENDER\\_RESPONSIVE\\_BUDGETING\\_MANUAL\\_FOR\\_MUNICIPALITIES](https://www.academia.edu/35979544/GENDER_RESPONSIVE_BUDGETING_MANUAL_FOR_MUNICIPALITIES)

UN Women (2015), *Gender Responsive Budgeting, Manual for CSOs* [https://www.academia.edu/35979545/Gender\\_Responsive\\_Budgeting\\_Manual\\_for\\_CSOs\\_ENG.pdf](https://www.academia.edu/35979545/Gender_Responsive_Budgeting_Manual_for_CSOs_ENG.pdf)







# ROMANACTED

*Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor*

SQI

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e kontinentit për të drejtat e njeriut. Përbëhet nga 47 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të bashkojnë njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Bashkarisht, kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qendrueshëm krahas ruajtjes së diversitetit kulturor, tolerancës dhe lirive individuale. Bashkimi Evropian angazhohet në ndarjen e arritjeve dhe vlerave me vendet dhe njerëzit përtej kufinjve të vet.

<http://europa.eu>

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës